



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor

“Inxhinieri Agrare, Profili: Mbrojtje Bimësh”

i

Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Bujqësor i Tiranës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr. Aleko Miho

Prof. Asoc. Valbona Sota

Korrik - 2019

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës

Programi i studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Inxhinieri Agrare”, profili: “Mbrojtje Bimësh” ofrohet për studentët nga Departamenti i Mbrojtjes së Bimëve, Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit, Universiteti Bujqësor i Tiranës. Ky Program studimi e ka zanafillën e tij që në vitin 1994, ku studentët diplomoheshin në: “Inxhinieri Agrare në Hortikulturë dhe Mbrojtje Bimësh”. Me anë të shkresës të MASH me Nr. 5208 prot, datë 17.07.2007, miratohet ndarja e kursit të studimit “ Inxhinieri Agrare në Hortikulturë dhe Mbrojtje Bimësh”, ku emërtimi i diplomës së programit do të ishte: “Bachelor në Inxhinieri Agrare në Mbrojtje Bimësh”. Me Urdhër të MAS Nr. 405, datë 08.09.2017 “Për regjistrimin e formave të diplomave “Bachelor” dhe “Master i Shkencave” të Universitetit Bujqësor të Tiranës”, regjistrimi në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave në arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, ky Program emërtohet si: Bachelor në: “Inxhinieri Agrare”, profili “Mbrojtje Bimësh”.

Programi i studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Inxhinieri Agrare, profili: Mbrojtje Bimësh” është i vetmi në Shqipëri, që përgatit ekspertë të mbrojtjes së bimëve, në këtë nivel, ose mbështetës kryesor për nivele më të larta të kërkimit, duke synuar për një bujqësi të qëndrueshme, për prodhime bujqësore të shëndetshme për tregjet tona dhe më gjerë. Kjo është një traditë që shtrihet prej vitit 1964, kur mbrojtja e bimëve është formuar si strukturë e veçantë mësimore dhe shkencore. Programi dallohet sot si një kurrikul bashkëkohore, me standarde kombëtare dhe ndërkombëtare, në drejtim të prognozës dhe diagnostikës së parazitëve bimorë, trajtimeve me pesticide, masave të tjera të kontrollit, me synim të kontribuojë në zhvillimin ekonomik dhe social në nivel kombëtar dhe rajonal. Zhvillimi i programit mbulohet nga një staf akademik dhe ndihmës, i kualifikuar, me përvojë vendase dhe ndërkombëtare, që mbulon një spektër të gjerë, nga shkencat e natyrës, bujqësi, dhe veçanërisht nga mbrojtja e bimëve (entomologji dhe fitopatologji), etj. Programi mbështetet nga mjedise mësimore-kërkimore dhe infrastrukturë e përshtatshme, si për mësimdhënie dhe për formimin praktik, nga bashkëpunime me biznese private, nga një infrastrukturë shërbimesh bashkëkohore dhe mjaft efektive, si dhe bashkëpunime të gjera rajonale.

Megjithatë, cilësia e programit do të rritej nëse, njësia përgjegjëse dhe Institucioni do të kujdeseshin në të ardhmen në disa çështje të tilla si: *i*) në Planin e studimit të dalin më qartë gjithë elementët e mësimdhënies; *ii*) të gjenden mënyra më të përshtatshme për rritjen e cilësisë së të rinjve që kërkojnë të ndjekin këtë Program studimi; *iii*) struktura e stafit mësimor ka nevojë të freskohet me të rinj, në dobi të uljes së ngarkesës dhe transmetimit të përvojës mes brezave; këtu rëndësi do të kishte edhe çbllokimi i kryerjes së doktoratave në institucion; *iv*) pavarësisht nga gjendja relativisht e kënaqshme në këtë njësi përgjegjëse, institucioni ka gjithmonë nevojë të rrisë buxhetin në dobi të zhvillimit cilësor të mësimit dhe të kërkimit, përfshirë këtu edhe motivim më të mirë të stafit akademik dhe ndihmës sipas performancës së tyre. Shumë prej këtyre komenteve i përkasin jo vetëm Njësisë dhe Institucionit, por dhe vetë Ministrisë përgjegjëse.

Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm; 200 fjalë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm ka në përbërje Prof. Aleko Miho, ekspert i biologjisë së ruajtjes (botanikë), Universiteti i Tiranës, dhe Prof. Asoc. Valbona Sota, eksperte e bioteknologjisë bimore, Universiteti i Tiranës. Grupi kreu fillimisht një kualifikim të shpejtë pranë ASCAL, ku u njoh me procedurën dhe gjithë materialet në dispozicion, të përgatitura nga Njësia përgjegjëse për Programin e studimit nën shqyrtim. Gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga koordinatoresha teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demirneli.

Grupit të ekspertëve të jashtëm iu vu në dispozicion i gjithë dokumentacioni i nevojshëm për vlerësimin e këtij programi studimi, i cili ishte depozituar në ASCAL nga vetë institucioni. Ky dokumentacion u shqyrtua me hollësi, veçanërisht Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (Dokumenti nr. 1 në Sistemin ASCAL: _1_RVB_Bsc_DMB_MB.pdf); ky dokument ishte mbështetja kryesore, jo vetëm për të njohur gjendjen, por edhe si udhëzues për t'u thelluar më tej në njohjen e programit, të vlerave dhe shqetësimeve. Gjatë vizitave në institucion, u kërkuan informacione të tjera shtesë sipas nevojave, të cilat institucioni i vuri menjëherë në dispozicion. Gjatë fazës së vizitave, u bënë takime me drejtues të institucionit dhe njësive përgjegjëse, përgjegjës, përfaqësuesit e stafit, studentë dhe palë të tjera interesi nga institucioni. Qëllimi i vizitës dy ditore ishte shqyrtimi i të dhënave dhe informacioneve, ballafaqimi me infrastrukturën në dispozicion të këtij program studimi etj. Të gjithë elementët e analizuar gjatë vizitës ishin të domosdoshëm për të përpiluar në mënyrë të plotë dhe korrekte këtë Raport të Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në: “Inxhinieri Agrare”, Profili: “Mbrojtje Bimësh”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Nga shqyrtimi i hollësishëm i dokumentacionit të depozituar (<i>Aneksi nr.7: Rregullore e programit të studimit, Neni 5</i>) vlerësohet se programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Agrare”, Profili: “Mbrojtje Bimësh” (MB) synon plotësisht ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave kombëtare, si dhe është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimet e institucionit në këtë fushë.

<p>Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Nga intervistat e realizuara gjatë ditëve të vizitës, por dhe nga informacioni i vënë në dispozicion (<i>Aneksi nr. 2: Statuti i UBT-së, Kru VII, Neni 49 dhe nr. 3: Strategjia e institucionit 2016-2025</i>), grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) thekson se ky program studimi synon plotësisht ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>			
<p>Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Veç të tjerash vlerësohet se ky program përkon me strategjitë e aplikuara për zhvillimin ekonomik të vendit.</p> <p>Ky program studimi është hartuar në përputhje me misionin e arsimit të lartë, si dhe me politikën udhëheqëse të Universitetit, të reflektuar në statutin e UBT, të miratuar në 2017. Në këtë dokument strategjik (<i>Aneksi 2 Statuti UBT_miratuar, Neni 2 pika 3</i>) citohet se: “synimi kryesor i UBT është të ofrojë arsimim të lartë, zhvillim të dijeve dhe shkencës, inovacionit dhe të profesioneve.” Gjithashtu, sipas Nenit 2, pika 1 të Statutit citohet se “UBT ka për mision edukimin profesional dhe kërkimin shkencor në fushat: prodhim bimor, prodhim shtazor; hortikulturë; mbrojtje bimësh; akuakulturë dhe peshkimi; agromjedis & mbrojtjen e tij; ekonomi agrare; politikat bujqësore; zhvillimi i interguar rural; menaxhimi i ndërmarrjeve; marketing; financë & kontabilitet; agroturizëm, bioteknologji dhe ushqim; industrinë e pijeve; mbarëshkrimin e pyjeve; industrinë drurit; mjekësinë veterinare & shëndetin publik etj.”</p>			
<p>Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Grupi i vlerësimit të jashtëm thekson veç të tjerash edhe faktin që, në nivel kombëtar, është i vetmi program studimi i këtij profili që ka traditë dhe vazhdimësi shumëvjeçare dhe rrjedhimisht i vetmi që përgatit në mënyrë periodike dhe të konsoliduar specialistë në këtë fushë. Programi është themelor edhe në përgatitjen e ekspertëve të mbrojtjes së bimëve për nivelet më të larta të shkollimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi I.2</p> <p>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se</p>	<p>Nga shqyrtimi i hollësishëm i dokumentacionit në nivel institucional (<i>Aneksi 3_Plani Strategjik UBT_miruar</i>)</p>

<p>programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>konstatohet qartë se programi i studimit është konceptuar në harmoni me strategjitë e institucionit, të cilat janë të fokusuara në dy drejtime kryesore: mësimdhënia dhe kërkimi shkencor. Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit dhe Departamenti i Mbrojtjes së Bimëve që kanë në përgjegjësi realizimin e këtij programi studimi, koordinojnë progresin e tyre me Planin e Zhvillimit Strategjik të Institucionit.</p>			
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Mbështetur në planin strategjik, në statutin dhe rregulloren e studimeve universitare të UBT si dhe në rregulloren e FBM (<i>Dok nr. 3_Plani Strategjik UBT_Miraturar.pdf; Dok nr 2_Statuti UBT_Miraturar_2018.pdf; Dok nr 6_Rregullore finale e FBM 2017-2018.pdf</i>), janë të përcaktuar qartë të gjitha dejtimit prioritar akademike, si i tillë është dhe programi Bsc. në “Inxhinieri Agrare, profili Mbrojtje Bimësh”; ndër të tjera ky program synon të përgatisë specialistë dhe kërkues agronomë në fushën e mbrojtjes së bimëve, të cilët do të jenë të aftë të drejtojnë zbatimin e paketave të kontrollit të integruar të parazitëve të kulturave bujqësore, duke garantuar mbrojtjen e prodhimit bujqësor. Njësitë përgjegjëse kanë përgjegjësi në realizimin e këtij programi studimi, koordinojnë me efikasitet progresin e tyre me Planin e Zhvillimit Strategjik të Institucionit (<i>Aneksi 3: Strategjia e institucionit 2016-2025</i>) dhe me rregulloret specifike të tyre (<i>dok. DVV nr. 6: Rregullore e FBM dhe Rregullore e DMB</i>).</p>			
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>Ekspertët vlerësojnë se konsolidimi shumëvjeçar i FBM dhe DMB garanton realizimin me efektivitet të këtij program studimi.</p> <p>Nga GVJ konstatohet se DMB funksionon në harmoni të plotë me strategjitë e FBM-së dhe kështu programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Agrare, profili “Mbrojtje Bimësh”, në tërë komponentët e tij, vlerësohet se ofrohet plotësisht në përputhje me fushat dhe drejtimit akademike të institucionit (<i>Aneksi nr. 6: Rregullore e FBM dhe Rregullore e DMB</i>).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi I.3</p>	
<p>Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

<p>Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Referuar Rregullores së programit (<i>Dok nr _7_Rregullore e PS_MB.pdf</i>), por edhe nga intervistat gjatë ditëve të vizitës rezulton se në këtë programi studimi objektivat e mësimdhënies janë të përshkruara qartë dhe përputhja është e plotë. Në fokusin kryesor vërehet të jetë përcjellja e njohurive të reja nëpërmjet mësimdhënies dhe standardeve të larta profesionale. Në lidhje me formimin e studentëve synohet pajisja e tyre me njohuritë që çojnë drejt studimeve të thelluara.</p> <p><i>Sipas rregullores së Programit të studimit Kreu II neni 6, disa nga objektivat specifike për këtë program janë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja e specialistëve Agronomë në fushën e mbrojtjes së bimëve, të cilët do të jenë të aftë të punojnë në fermat prodhuese në administratën publike, si dhe në fushën e kërkimit shkencor bujqësor; - Njohuritë e thelluara të përvetësuar nëpërmjet këtij Programi për fusha të tilla si: fitopatologji, entomologji bujqësore, menaxhimi i produkteve të mbrojtjes së bimëve kontrolli biologjik etj; - Sistemi i njohurive të thelluara që ofrohet nga ky program, ju jep studenteve mundësinë për ndjekjen e studimeve në nivele të tjera që lidhen me kërkimin aplikativ dhe fundamental në shkencat bujqësore; - Të përafrohet kurrikula e departamentit të mbrojtjes së bimëve me atë të departamenteve analoge të universiteteve më të mira në fushën e bujqësisë, veçanërisht në fushën e mbrojtjes së bimëve;
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Mbështetur në Rregulloren e Studimeve të UBT (<i>Dok nr. _5_Rregullorja-e-Studimeve_UBT_Final-Version_Dhjetor-2018-1.pdf</i>), përcaktohet se programet e studimit të ciklit të parë "Bachelor" ofrohen në përputhje me misionin dhe vizionin e UBT, si dhe Fakulteteve dhe Departamenteve brenda tij, dhe në përputhje me strategjinë për zhvillim të UBT (<i>Dok nr _4_Plan strategjia e zhvillimit te UBT, 2016-2025.pdf</i>). Ato janë hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës, me zhvillimin ekonomik të vendit, dhe nuk bien ndesh me interesat dhe programet e tjera, të ofruara nga institucione të tjera të arsimit të lartë.</p> <p>Nga vlerësimi i informacionit rezulton se programi i studimit është në përputhje me nevojat e tregut (<i>Dok nr _19_Kurrikula _2018-2019.pdf; Dok nr _19_Kurrikula 17-18.pdf</i>), por nuk shihet ndonjë studim i bërë për këtë treg në lidhje me nevojat për profesionistë që synon të prodhojë ky institucion.</p>

	<p>Tabela përmbledhëse për punësimin real të studentëve (<i>Aneksi_17_Studentet</i>) flet në mënyrë të përgjithshme mbi punësimin e studentëve në nivel fakulteti ose më gjerë, dhe <i>nuk specifikohet edhe nëse punësimi është brenda profilit të diplomimit apo jo.</i></p> <p>Gjatë intervistave me përfaqësues të QKA, por edhe nga shqyrtimi i dokumentacionit, vërehet se institucioni insiston në mënyrë të vazhdueshme duke mbajtur kontaktet me studentët e diplomuar, <i>por vërehet një pasivitet nga këta të fundit për të plotësuar formularët online pasi punësohen.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Nga vlerësimi rezulton se ky është një program studimi, me qëndrueshmëri, traditë dhe vazhdimësi shumëvjeçare, dhe si i tillë është unik në nivel kombëtar për sa i përket cilësive të lartpërmendura. Struktura e kurrikulës së programit, rezultatet dhe objektivat e të nxënit për studentët të dhëna në secilin modul, janë në funksion dhe në përputhje me objektivat e përgjithshme të Programit (Dok nr._19_Kurikula _2018-2019.pdf ; Dok nr._19_Kurrikula 17-18.pdf ; Dok nr._19_Syllabuset Bachelor -.pdf).</p> <p>Në lidhje me sa më sipër rezulton se ky program garanton plotësisht formimin teorik dhe praktik të specialistëve me aftësi të larta në fushën përkatëse, një domosdoshmëri themelore e tregut në ditët e sotme.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi I.4</p> <p>Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>UBT është universiteti i vjetër publik, i cili në vite ka krijuar traditë të nivelit të lartë të trajnimit të stafit me përvojë brenda dhe jashtë vendit. UBT dallohet për staf të aftë profesional dhe shumë të përgatitur (<i>Aneksi 23_UB_Personel akademik & ndihmës akademik</i>). Programi i studimit mbështetet nga stafi akademik i vetë DMB, si dhe të departamenteve të tjera</p> <p>Nga vlerësimi i dokumentacionit dhe vizitave në institucion rezulton se ekzistojnë të gjitha kapacitetet si në infrastrukturë, ashtu dhe në burime njerëzore, përvojë akademike dhe</p>

	<p>struktura ndihmëse universitare mjaft efektive, gjë që rrit efektivitetin e ofrimit të këtij program studimi. Stafi akademik është i kualifikuar, me një përvojë shumëvjeçare në këtë fushë studimore dhe aplikative, gjë që mundëson rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor</p> <p><i>(Aneksi 23_UB_Personel akademik & ndihmës akademik; Aneksi 67_Numri i pedagogëve, Fakultet, Departament).</i></p>			
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit Bsc. në “Inxhinieri Agrare, profili Mbrojtje Bimësh”, është program studimi i ciklit të parë të studimit, referuar nivelit të 6 të kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, organizohet me jo më pak se 180 kredite evropiane dhe kohëzgjatje normale tri vite akademike, në përputhje me nenin 70 pika 4 e Ligjit 80/2015.</p> <p>Programi ofrohet nga DMB, i FBM, në përputhje me rregulloren e Programit <i>(Dok nr._7_Rregullore e PS_MB.pdf)</i>.</p> <p>Veç të tjerash rezulton se DMB, drejton dhe menaxhon me përgjegjësi të plotë mbarëvajtjen e këtij programi studimi, proces që është në përputhje të plotë me Rregulloren e Studimeve dhe me Planin Strategjik të UBT <i>(Aneksi. 5_Rregullore e studimeve UBT; Aneksi. 4: Plani strategjik UBT)</i>, dhe me Rregulloren e Brendshme të Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit <i>(Aneksi. nr. 6)</i>.</p>			
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Për këtë program studimi është miratuar një rregullore e posaçme, e cila është në koherencë të plotë me rregulloren e departamentit <i>(Aneksi nr. 7: Rregullorja e programit të studimit; Aneksi nr. 6: Rregullorja e departamentit)</i></p> <p>Gjithashtu rezulton se ky program studimi është hartuar në përputhje dhe me direktivat evropiane dhe ka një harmonizim mjaft të mirë me programin e studimit të masterit shkencor “Mjekësi Bimore” që zhvillohet nga e njëjta njësi përgjegjëse.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi I.5	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Si përmendet më lart, nga vlerësimi rezulton se DMB menaxhon dhe drejton me efektivitet këtë program studimi. Mbarëvajtja dhe mbikëqyrja e programit të studimit bëhet në formë të koordinuar nga të gjitha instancat drejtuese së UBT.</p> <p>Vërehet një bashkëpunim i ngushtë me të gjitha strukturat e institucionit (ZSS, QKA etj.), në mënyrë që të lehtësohet i gjithë aktiviteti i studentëve brenda institucionit gjatë të gjitha viteve të studimit, dhe të rritet efektiviteti i këtij program studimi.</p> <p>Është mëse e qartë se edhe brenda DMB, i gjithë stafi akademik dhe ndihmës/akademik përmbush me përpikmëri detyrimet profesionale dhe detyrat e caktuara në dobi të rritjes së cilësisë së këtij program studimi.</p> <p>Për të vlerësuar performancën dhe arritjen e objektivave të programit të studimit, institucioni kryen analiza periodike/vjetore në nivel fakulteti, departamenti dhe për njësi të tjera të sigurimit të cilësisë (<i>Dok nr. nr. 37: Raportet vjetore të publikuara për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë dhe Dok nr.nr. 38: Analizë e Departamentit përgjegjës (vjetore/periodike) mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësisimit profesional</i>)</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Janë të dokumentuara qartë marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione vendase apo të huaja, të sektorit publik apo privat, gjë që paraqet një rëndësi të madhe për shkëmbim përvojash, lidhjes me tregun e punës, rritjes së mundësisë për punësim, kualifikimeve të mëtejshme të studentëve nëpërmjet praktikave profesionale etj. (<i>Aneksi nr. 32: Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit dhe/ose të huaj dhe për praktikën profesionale</i>).</p> <p>Një rol mjaft të rëndësishëm është dhe përfshirja në projekte të rëndësishme ndërkombëtare, e cila rrit kapacitetet e mësimdhënies, të kërkimit shkencor, si dhe të kualifikimeve të vazhdueshme të stafit akademik dhe studentëve (<i>Aneksi nr. 32: Marrëveshjet Erasmus</i>).</p>

<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Gjatë intervistave me stafin e DMB, por edhe nga shqyrtimi i RVB pretendohet se njësia përgjegjëse për këtë program studimi harton periodikisht raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve, <i>por kjo nuk dokumentohet mjaft qartë.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Praktika mësimore e studentëve realizohet në bazë të një marrëveshje institucionale ndërmjet Universitetit dhe institucionit pritës së studentit për ushtrimin e praktikës mësimore. Marrëveshja finalizohet nëpërmjet nënshkrimit të kontratës përaktëse. <i>(Dok nr._32_ Marreveshjet e bashkepunimit me institucionet homologe brenda dhe jashte vendit, aktoret e biznesit vendas ose te hu~1.pdf)</i></p> <p>Konstatohet se gjatë tri viteve të studimit bachelor, studentët realizojnë praktikën në institucione të sektorit privat me të cilat institucioni ka kryer marrëveshje paraprake <i>(Dok nr._32_Tabele permbledhese me institucionet bashkepunuese, per programin e studimit.pdf).</i></p> <p>Rezulton se numri i studentëve që marrin pjesë në këto praktika mësimore është i lartë.</p> <p><i>Por nuk dokumentohet mjaft qartë mënyra e mbikëqyrjes nga vetë institucioni mbi frekuentimin e rregullt të ditëve të praktikës, efektivitetin e tyre etj.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Është e dokumentuar qartë se institucioni i ofron këto mundësi trainimi profesional në sajë të marrëveshjeve paraprake vetëm gjatë viteve të studimit bachelor, <i>por pas diplomimit nuk dokumentohen marrëveshje që vërtetojnë këtë mundësi për të diplomuarit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	<p>Programi i studimit organizohet në lëndë e module (<i>Dok nr. _19_Kurikula _2018-2019.pdf; Dok nr _19_Syllabuset Bachelor -.pdf; Dok nr _59_Guida Bachelor.pdf</i>), ku secila vlerësohet me kredite sipas sistemit ECTS, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ka një kohëzgjatje prej 3 vitesh dhe në total 180 kredite.</p> <p>Gjatë procedurës së vlerësimit GVJ konstaton se DMB është i organizuar në dy grupe mësimore, përkatësisht Entomologji dhe Fitopatologji. Anëtarët e njësisë bazë janë të angazhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në hartimin e syllabuseve dhe në realizimin e këtij programi studimi</p> <p>(<i>Aneks nr. 19: Syllabuset e lëndëve</i>).</p>
Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.	<p>Ky program studimi ofron njohuri dhe kompetenca bazë të domosdoshme për vijimin e studimeve të ciklit II; është i harmonizuar mjaft mirë me të dyja programet e ciklit të dytë të DMB.</p> <p>Nga shqyrtimi i (<i>Aneksi. nr. 19 i kurrikulës</i>), rezulton se në 4 semestrat e parë ofrohen lëndë themelore të formimit bazë dhe që përfshijnë një spektër të gjerë njohurish të domosdoshme.</p>
Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuara në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	<p>Një aspekt tepër i rëndësishëm dhe themelor në vlerësimin e efektivitetit të çdo programi studimi është mënyra se si ai formon studentët në të menduarin kritik dhe vlerën që ka si në aspektin teorik dhe atë praktik.</p> <p>Nga shqyrtimi i kurrikulës dhe planit mësimor rezulton se gjatë semestrit të 5 dhe të 6, lëndët specializohen ngushtësisht brenda këtij programi, madje në semestrin 6 shumica e lëndëve që ofrohen janë me zgjedhje; ky është një element mjaft i rëndësishëm për t'i dhënë mundësi studentëve që të profilizohen ngushtë brenda preferencave të tyre për studim të thelluar (<i>Dok nr. _19_Kurikula _2018-2019.pd; Dok nr _19_Kurrikula 17-18.pdf; Dok nr _19_Kurrikulat _2016-2017.pdf</i>).</p>
Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në	<p>Konstatohet qartë se, si unik me këtë vazhdimësi dhe qëndrueshmëri ndër vite në nivel kombëtar, ky program studimi mundëson formimin e specialistëve të fushës me kompetenca të larta, të cilët janë të domosdoshëm për</p>

fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	zgjidhjen e emergjencave apo problematikave bujqësore kombëtare, rajonale etj. (<i>Dok nr _59_Guida Bachelor.pdf</i>).			
Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	Nga shqyrtimi i hollësishëm i dokumentacionit rezulton se ky program studimi, përsa i përket strukturës dhe elementëve përbërës të tij, është në përputhje të plotë me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Gjithashtu, programi është saktësisht i shpërndarë me ngarkesat përkatëse sipas elementëve të zhvillimit të njohurive, leksione, seminare, laboratore etj.			
Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Në rregulloren e programit të studimit (<i>neni 9</i>), mbështetur edhe në VKM 41 (2018), paraqiten grupet e klasifikimit të veprimtarive formuese të pasqyruara në programin e studimit. Nga shqyrtimi i kurrikulës, syllabuseve etj. rezulton se ky program studimi ka një ndarje të qartë të lëndëve sipas kategorive të përcaktuara, dhe secila prej tyre ka të përcaktuar ngarkesën përkatëse në kredite duke e respektuar sasinë vjetore prej 60 kreditesh (<i>Dok nr _19_Kurikula _2018-2019.pdf; Dok nr _19_Kurrikula 17-18.pdf; Dok nr _19_Kurrikulat _2016-2017.pdf</i>).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit, pranë UBT është njësia kryesore e strukturuar për të ofruar programe studimi, në përputhje me Ligjin 80/2015. Bazuar në dokumentat e Strukturës organizative, Statutit dhe rregullores së UBT, si edhe mbi kërkesat ligjore, pranohet se njësia kryesore – fakulteti përmbush detyrimet ligjore përkatëse. Ai përbëhet nga 6 Departamente. Nga shqyrtimi i (<i>Aneksi nr. 23: Personeli akademik dhe</i>

	<i>ndihmës akademik</i>), rezultoi se DMB si njësi kryesore përgjegjëse për këtë program studimi i plotëson kriteret, si për personelin akademik në total, ashtu edhe për kërkesat në lidhje me kualifikimin e tij. Departamenti ka në përbërjen e tij 14 staf akademik efektiv, të gjithë me grada/tituj.			
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.	Nga shqyrtimi i dosjes së vetëvlerësimit, si edhe takimeve gjatë vizitës në institucion, rezultoi se njësia përgjegjëse ka caktuar në rolin e koordinatorit të programit, përgjegjës të DMB.			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Organizimi i njësisë kryesore në departamente, stafet akademike përkatëse për secilin departament përmbushin detyrimet ligjore. DMB është i organizuar në dy grupe mësimore, përkatësisht Entomologji dhe Fitopatologji, dhe ka staf të kualifikuar sipas kriterëve ligjore në fuqi.			
Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.	Nga shqyrtimi i syllabuseve (<i>Aneksi nr. 19: Syllabuset e lëndëve</i>) rezulton se në këtë programi studimi pjesa më e madhe e lëndëve realizohen nga staf akademik i DMB. Nga analizimi i dokumentacionit të paraqitur dhe nga vizita në Zyrën e Burimeve Njerëzore konstatohet se DMB përbëhet nga 14 anëtarë personel akademik, nga të cilët 9 janë të kategorisë ‘profesor’. Konkretisht kualifikimet e stafit të këtij departamenti janë: 6 Prof; 3 Prof. As. Dhe 5 Dr.			
Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Rezulton e dokumentuar qartë se DBM përmbush detyrimet ligjore përsa i përket organizimit në gruplëndë, strukturës akademike, kualifikimeve të stafit, ngarkesës mësimore në auditor të detyrueshme sipas kategorive përkatëse të personelit akademik ‘mësimor’ apo ‘kërkimor’, etj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ndërtohen bazuar në gjithë informacionin mbi programin e studimit, stafin akademik dhe strukturat e njësisë kryesore dhe njësisë bazë. Gjatë shqyrtimit të DVV (dok. nr. 6: Rregullore e departamentit), dhe (dok. nr. 7: Rregullore e programit të studimit; Dok nr _59_Guida Bachelor.pdf) rezultoi se janë të përcaktuara qartë organizimi dhe struktura e programit të studimit.
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Sipas nenit 9 të rregullores së programit të studimit, veprimtaritë formuese të programit të studimit përfshijnë: lëndë bazë; lëndë karakterizuese; lëndë ndërsiplinore/integruese; lëndë plotësuese; detyrime përmblylëse, dhe provimi i përgjithshëm përfundimtar ose punimi i diplomës.
Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	<i>Nga shqyrtimi i detajuar i kurrikulës dhe syllabuseve, nuk paraqitet qartë ndarja e elementëve të lëndës (leksion, seminar, laborator).</i>
Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	<i>Në shumicën e rasteve rezulton se kategoritë ‘seminar’ dhe ‘laborator’ përfshihen në një kategori të vetme. Kjo duket edhe në faqen e DMB lidhur me Kurrikulën e Studimeve të Mbrojtjes së Bimësh Bachelor, për Vitin Akademik 2018-2019 (http://ubt.edu.al/wp-content/uploads/2019/02/Kurrikula-Bsc-DMB-2018-2019-1.pdf; si dhe në (dok. nr. 19).</i>
Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	<i>Në Strukturën e programit të studimit, dhe në Planin Mësimor (Dok nr _25_DMB_Planet Mesimore_18-19 Dep. Mb. Bimeve.pdf, edhe ky jo i plotë në dokumentat e ASCAL; Dok nr _59_Guida Bachelor.pdf) duhet të dalë qartë kategoria e secilës veprimtari formuese, sipas tabelës 1 të VKM 41, dt. 24.1.2018, konkretisht sipas kategorive A-E.</i>
Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për	<i>Në Planin mësimor duhet të saktësohet edhe varësia mes lëndëve të ngjashme që ka caktuar njësia përgjegjëse për Programin e studimit, si dhe sasia e krediteve që duhen përftuar për të kaluar në vitin pasardhës.</i>
	Syllabuset e lëndëve janë të paraqitur në strukturë sipas vendimit nr. 41, dt. 24.01.2018. Por grupi i ekspertëve gjykon që ky udhëzim nuk është kufizues, por lejon zgjerimin

<p>programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p><i>e detajuar të elementëve të secilës veprimtari mësimore në mënyrë që të dalë në pah edhe më qartë lidhja dhe raporti teori - praktikë. Diçka e tillë është me rëndësi të madhe veçanërisht në rastin e programeve të tilla të studimit me karakter të theksuar aplikativ, të cilët pikën e tyre të fortë kanë pikërisht tematikat e laboratoreve, si dhe praktikat mësimore dhe profesionale në terren. Në këtë kontekst, gjykohet se në çdo syllabus duhet të saktësohen të gjitha elementët e veprimtarisë mësimore. Këshillojmë që Syllabuset e Programit (Dok nr _19_Syllabuset Bachelor -.pdf; Dok nr _59_Guida Bachelor.pdf) të bëhen të dukshme në faqen e DMB.</i></p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Nga shqyrtimi i detajuar i (dok. nr. 25: Planet mësimore), rezulton se të gjitha veprimtaritë mësimore (lëndët apo modulet) shlyhen me provime gjatë periudhës së sezonit, duke e rritur shumë numrin e provimeve në një sezon. Në mënyrë që të lehtësohet puna e studentëve gjatë sezonit, grupi vlerësues sugjeron të shihet mundësia e kalimit të disa lëndëve me vlerësim të vazhduar (VLV).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi II.4</p> <p>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxëniet dhe vazhdimet të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Duke iu referuar Ligjit 80/2015 “Për arsimin e Lartë në RSH”, neni 70 pika 4, programet e studimit në Institucionet e Arsimit të Lartë organizohen në tre cikle të njëpasnjëshëm, i parë, i dytë dhe i tretë, sipas nivelit 6-8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Referuar (dok. nr. 25: Plani mësimor), ky program studimi është i organizuar në tre vite akademike, me 60 kredite në një vit akademik dhe 180 kredite në total. Konstatohet se është në përputhje të plotë me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë,</p>	<p>Emërtimi i diplomës së programit të studimit është i përcaktuar në dokumentin e krijimit, në dokumentin e kurrikulës, programit mësimor, planit, rregulloreve përkatëse si edhe moduleve të lëndëve (Dok nr _59_Guida</p>

<p>njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p><i>Bachelor.pdf</i>).</p> <p>Nga GVJ konstatohet se ky program studimi mundëson përgatitjen e studentëve me aftësi teorike dhe praktike mjaft të larta, elementë të rëndësishëm për t'u përballur më lehtë me tregun e punës pas diplomimit të tyre (<i>Dok nr _59_Guida Bachelor.pdf</i>). Përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe e praktikave mundësojnë njohuri bashkëkohore dhe atraktive për studentët, ato janë të organizuara sipas objektivave të formimit dhe mundësojnë marrjen e njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme si dhe punësimin</p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Në lidhje me atë çfarë është shprehur në standardin II.3, në mënyrë që i gjithë informacioni që shkon tek publiku i gjerë të jetë sa më i qartë dhe i kompletuar, <i>sugjerohet që në syllabuset e lëndëve të pasqyrohet jo vetëm tematika e leksioneve, por dhe temat e detajuara të laboratorëve dhe/ose praktikave mësimore. Rrjedhimisht është e domosdoshme të paraqitet e detajuar qartë ngarkesa e laboratoreve/praktikave javore dhe semestrave.</i></p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Nga shqyrtimi i (<i>dok. plani mësimor bachelor mbrojtja e bimëve, të marrë gjatë vizitës në institucion</i>) rezulton se të gjitha lëndët janë në përputhje me profilin e programit, dhe rrjedhimisht të domosdoshme për formimin e specialistëve në këtë fushë studimi. Nga infrastruktura, kapacitetet e laboratoreve, bisedat me stafin etj, rezulton qartë se raporti teori/praktikë është mëse i kënaqshëm për finalizimin me sukses të programit, <i>por diçka e tillë duhet të paraqitet më qartë në dokumentacion.</i></p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Disa dokumenta janë në dispozicion për të identifikuar mundësitë që ndërtimi i programit lejon për mobilitete, transferime dhe punësim në përfundim të studimeve.</p> <p>Nga shqyrtimi (<i>dok. nr. 32: Marrëveshjet Erasmus</i>) rezulton se institucioni ka një sërë marrëveshjesh mobiliteti në kuadër të programit Erasmus, dhe studentët gjatë intervistave dëshmuar për realizimin e tyre. Kjo gjë që përforcon faktin se përmbajtja e këtij programi studimi mundëson përshtatje me universitete të huaja në rajon.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në</p>	<p>Në dokumentin e paraqitur në dosje rezulton se për pjesën më të madhe të lëndëve ekzistojnë tekstet përkatëse, <i>por dokumentacioni i siguruar nuk jep informacion mbi vitin e botimit, nëse teksti është i miratuar në një njësi të FBM, nëse</i></p>

literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	<i>ka kaluar në proces recensimi etj. Megjithatë, nga shqyrtimi i detajuar i (dok. nr. 19: Syllabuset bachelor), rezulton se tekstet mësimore janë pas viteve 2010 dhe të paktën 50% të tyre rezultojnë të botuar pas vitit 2015.</i>			
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.	Duke ju referuar DVV, është e qartë se ky program studimi ka një përmbajtje të tillë të lëndëve/moduleve që garanton formimin e specialistëve me aftësi dhe kompetenca të kënaqshme për këtë nivel studimi (dok. nr. 19: Syllabuset bachelor, Dok nr 59; _Guida Bachelor.pdf).			
Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Duke ju referuar DVV, konstatohet se ky program studimi është në harmoni dhe koherencë të plotë me programin e studimit të ciklit II, master i shkencave në ‘Mjekësi bimore’, duke demonstruar qartë se mundëson përgatitjen e studentëve për studime më të thelluara në ciklin pasardhës (dok. nr. 7: Rregullore e programit të studimit, neni 6).			
Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Bashkëpunëtorët dhe partnerët nga tregu i punës janë pjesë e marrëveshjeve të departamentit për praktikantët e studentëve (Dok nr. _32_ Marreveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit, aktoret e biznesit vendas ose te hu~1.pdf). Institucioni ka të dokumentuara marrëveshje me partnerë të tregut të punës për zhvillimin e praktikave mësimore dhe profesionale, por nuk vërehet dokumentacion që vërteton pjesëmarrjen e përfaqësuesve dhe bashkëpunëtorëve nga tregu i punës në përmirësimin e kurrikulave të këtij programi studimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5	
Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat	Personeli akademik i DMB dhe ai jashtë departamentit që angazhohet në realizimin e programit të studimit, i përmbush kriteret sipas ligjit, lidhur me rolin që realizojnë në mësimdhënie dhe aktivitetet kërkimore e shkencore duke

<p>ligjore në fuqi.</p>	<p>u bazuar në tituj e grada.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezultoi se janë gjithsej 42 personel akademik efektiv i angazhuar në realizimin e këtij program studimi, nga ku 17 Prof.Dr., 12 Prof.Asoc., 10 Dr. dhe 3 Msc. (<i>dok. nr. 67: Numri i pedagogëve, fakulteteve, departamenteve</i>).</p> <p>Nga vlerësimi sa më lart, rezulton se pjesa më e madhe e moduleve në këtë program studimi mbahen nga staf akademik i departamenteve të tjera brenda institucionit. Shqyrtimi i detajuar i CV-ve të këtij stafi akademik (<i>dok. nr. 20</i>) konstatohet se ata janë të kualifikuar për të mbuluar me efektivitet modulet përkatëse në këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Nga sa vërehet, mosha mesatare e stafit akademik të DMB si njësi përgjegjëse është mbi 55 vjeç; gjithsej në personelin akademik mësimor janë vetëm 2 me gradën shkencore ‘doktor’, ndërsa të tjerët i përkasin kategorisë ‘profesor’. 3 doktorë të tjerë janë të profilit ‘kërkimor’, dhe si rrjedhojë ata kanë normë mësimore të reduktuar.</p> <p><i>Në të tilla kushte, rekomandohet rekrutimi i stafit të ri në moshë, pasi është i domosdoshëm transmetimi i përvojës ndërmjet brezave.</i></p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Duke ju referuar rregullores së DMB (<i>dok. nr. 6: Rregullore e departamentit, neni 9</i>), rezulton se departamenti është i strukturuar qartë në dy grup lëndë, konkretisht ‘Fitopatologji’ dhe ‘Entomologji’, ku secila prej tyre ka personel akademik në përputhje të plotë me fushën e specializimit të ngushtë të gjithësecilit prej tyre.</p> <p>Shqyrtimi i hollësishëm i CV-ve (<i>dok. nr. 20</i>) dëshmon se personeli akademik është mjaft i përgatitur dhe i specializuar ngushtësisht në një drejtim shkencor dhe aplikativ specifik, në përputhje dhe me gruplëndën ku është i përfshirë dhe modulet që mbulon të paraqitura në mënyrë të detajuar në syllabus (<i>dok. nr. 19</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin,</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit (<i>dok. nr. 32: Marrëveshjet me institucione publike apo private</i>) rezulton se praktikat profesionale realizohen mbi bazën e marrëveshjeve me bizneset, por nuk ka ndonjë dokumentacion që verifikon monitorimin nga IAL. Në fund të praktikës profesionale merret vetëm një vërtetim nga administrator i biznesit. Këto praktika nuk rezulton të jenë të monitoruara nga staf akademik apo ndihmës mësimor i brendshëm.</p>

udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Vlerësohen si mjaft pozitive bisedimet me Universitetin e Zagrebit, Kroaci, si dhe me JLU në Giessen, Gjermani, për mundësinë e shkëmbimit të studentëve në praktikat profesionale (internship), kurseve trainuese, në kuadrin e projekteve ERASMUS ICM, si dhe projekteve me DAAD dhe BMBF tashmë të fituara.			
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, (<i>dok. nr. 23: Personeli akademik dhe ndihmës akademik</i>), si dhe nga vizita në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, rezulton se DMB ka 8 anëtarë të personelit ndihmës akademik, të cilët janë të angazhuar plotësisht jo vetëm në ndihmë të procesit mësimor, por edhe të kërkimit shkencor dhe shërbimeve për të tretët.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	UBT i ka përshtatur prej kohësh këto metoda, si: e-learning; google site; moduli online “Njohuri për informacionin”; MOODLE; TEEAL; Sistemi Esse3. Gjithashtu, UBT ka një udhëzues të nivelit bazë për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies (<i>Dok. nr. 39: Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies</i>).

<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Nga vizita në institucion në takimin me NJSBC dhe me studentët, u konstatua si kjo realizohet në mënyrë të matshme vetëm nëpërmjet pyetësorit që plotësohet nga studentët nëpërmjet një pyetësori që plotësohet me shkrim.</p> <p>Për vitin akademik 2018 – 2019, për herë të parë u përfshi një pyetësor që plotësohet <i>on line</i>. Rezulton se të dhënat e gjeneruara i transmetohen përgjegjësit të departamentit dhe analizohen gjatë mbledhjeve me stafin.</p> <p>Konstatohet se dekanati realizon monitorime të faktit nëse zhvillohet apo jo në mënyrë të rregullt procesi mësimor, <i>por jo vlerësim cilësie të procesit të mësimdhënies</i>.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të DVV, si dhe vizitave në institucion, rezultoi se institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, e të vlerësimit të dijeve. Kjo realizohet nëpërmjet pyetësorit të vlerësimit (<i>Dok nr _16_Pyetsori i vetevlerësimit per vitin 2015 NR 81 1 date 29.01.2016.pdf; Dok nr _40_FBM_Anketimi_Feb_2019.pdf</i>), i cili synon tërheqjen e opinioneve të studentëve lidhur me procesin e mësimdhënies dhe çdo problematikë tjetër lidhur me to. Rezultatet përpunohen nga një grup pune me përfaqësues nga dekanati dhe departamenti dhe analizohen dhe shpërndahen në departamente. Rezultatet e tij janë pjesë e analizës vjetore të njësisë bazë dhe kryesore (<i>Dok nr _38_FBM raporti analizes mesimore 2016-2017.pdf; Dok nr _40_Raport Analiza Anketim_March_2017 (2).pdf</i>). Rezultatet individuale diskutohen ndërmjet përgjegjësit të departamentit dhe pedagogut duke u vënë në pah elementë që mund të kene nevojë për përmisim.</p> <p><i>U konstatua se numri i studentëve që e plotësojnë është i ulët në krahasim me numrit total të studentëve. Edhe nga diskutimet me studentët vërehet një farë shpërfillje nga këta të fundit për mosplotësimin në masë të këtyre pyetësorëve.</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Nga intervistat me personelin akademik rezulton se ata njoftohen në mënyrë periodike mbi rezultatet e vlerësimit. Ky njoftim realizohet nga përgjegjësi i departamentit gjatë mbledhjeve me stafin dhe aty diskutohet dhe mbi këto rezultate në mënyrë që të përmirësohet cilësia e mësimdhënies, nisur nga shqetësimet e evidentuara.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të</p>	<p>Plotësimi i pyetësorëve realizohet dhe administrohet nga përgjegjësi i departamentit dhe sekretarja e departamentit, gjatë orëve të leksioneve në javën e 14 dhe 15 të semestrit të</p>

<p>marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>parë dhe të dytë në çdo vit akademik. Të dhënat hidhen në një database ku dhe përpunohen</p> <p><i>(Dok nr _40_Raport_Analiza_Anketim_March_2017 (2).pdf).</i></p> <p>Si u theksua edhe më lart, rezultatet përpunohen nga një grup pune me përfaqësues nga dekanati dhe departamenti dhe analizohen dhe shpërndahen në departamente. Rezultatet e tij janë pjesë e analizës vjetore të njësisë bazë dhe kryesore. Rezultatet individuale diskutohen ndërmjet përgjegjësit të departamentit dhe pedagogut duke u vënë në pah elementë që mund të kene nevojë për përmisim.</p> <p><i>Nuk është e dokumentuar se në ç'mënyrë institucioni promovon shembujt më të mirë, por grupi vlerësues sugjeron gjetjen dhe aplikimin e mekanizmave të tillë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.2</p> <p>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Gjatë takimit me stafin akademik të këtij program studimi u diskutua se përmisimi i metodave të mësimdhënies dhe mësimnxënies përbën një ndër prioritetet kryesore të departamentit. GVJ konstaton se në këtë program studimi praktikohen elementë të shumtë të veprimtarisë mësimore <i>(dok. nr. 5, 6, 7: Rregullore UBT, DMB, PS-MB).</i></p> <p>Edhe gjatë intervistave me studentët dëshmohet qartë që janë të informuar që në fillim të semestrit; gjatë zhvillimit të lëndës aplikohen praktikisht forma të larmishme të transmetimit të dijeve <i>(Dok nr _59_Guida Bachelor.pdf).</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje</p>	<p>Rezulton se personeli akademik përshtatet dhe i përgjigjet plotësisht nevojave të studentëve, bazuar në prurjet periodike të çdo viti dhe prirjet individuale të tyre.</p> <p>Ajo që vërehet është prurja e studentëve me notë mesatare relativisht të ulët, për vitin akademik 2018 – 2019 nota mesatare ishte 6.74 <i>(dok. nr. 27: Mesataret e studentëve).</i></p> <p><i>Në të tilla kushte, gjetja e formave të larmishme të</i></p>

<p>me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p><i>transmetimit të dijeve është faktor kyç për nxitjen e interesit tek studentët dhe ngulitjen e elementëve themelorë teorikë dhe praktikë për këtë program studimi.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Gjatë vizitës në mjediset e institucionit rezultoi se infrastruktura dhe baza materiale në auditore dhe laboratore, në dispozicion të personelit akademik dhe studentëve, lejon dhe mundëson aplikimin efektiv të metodave të shumëllojshme të mësimdhënies.</p> <p>Mjediset e institucionit kanë <i>WiFi</i>; sallat e leksioneve seminareve janë të përshtatshme, të pajisura me videoprojektor, tabela për të shkruar, postera informues, kanë sistem ngrohje-ftohje etj.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>DMB ka personel akademik mjaft të kualifikuar në varësi të specialiteteve. Ndarja në 2 gruplëndë të profilizuara në mënyrë specifike e dëshmon qartë këtë çështje (<i>dok. nr. 6: Rregullore e DMB</i>). Edhe vetë studentët gjatë intervistave shprehen se janë mjaft të kënaqur nga niveli i kualifikimit të stafit akademik dhe format e transmetimit të dijeve prej tyre. Konstatohet se rekrutimi i personelit akademik kryhet bazuar në rregulloren e rekrutimit të stafit (<i>dok. nr. 11</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Nga intervistat e kryera rezultojnë se bashkëpunimi pedagog-student përsa i përket informimit mbi lëndën, udhëzimin mbi detyrat e pavarura, apo aspekteve të tjera në dobi të përmirësimit të procesit të mësimdhënies është plotësisht i realizuar. Konstatohet se studentët në mënyrë periodike plotësojnë pyetësorët e vlerësimit të formave dhe metodave të mësimdhënies (<i>dok. nr. 82: Anketimi</i>).</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>Nga intervistat gjatë ditëve të vizitës rezultojnë se ky element është plotësisht i realizuar. Sipas udhëzuesit për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies (<i>Dok nr _39_Udhezues ne nivel institucional per zvellimin dhe perdorimin e metodave inovative te mesimdhënies (1).pdf</i>) UBT ka përshtatur prej kohësh metodat inovative të mësimdhënies:</p> <p>1.e-learning, është një mënyrë elektronike e të mësuarit që nënkupton dhënie e njohurive mësimdhënies duke</p>

	<p>shfrytëzuar teknologjinë elektronike.</p> <p>2. google site, është një aplikacion on-line që ndihmon në krijimin e një projekti në web ose të një faqe web-i, lista e websiteve personale të pedagogëve të UBT.</p> <p>3. Moduli on-line “Njohuri për informacion”, është rezultat i projektit TEMPUS 517117-1-2011-IETEMPUS-JPHES, “Zhvillimi i njohurisë për informacion për të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe një ekonomi të bazuar mbi dijen në vendet e Ballkanit Perëndimor”.</p> <p>4. MOODLE, i njohur edhe si Mjedisi Virtual i të mësuarit, i cili është një mjet për krijimin nga ana e pedagogut të faqeve web dinamike për studentët e tyre.</p> <p>5. TEEAL, është një bibliotekë on-line e aplikuar në UBT.</p> <p>6. Esse 3 është një sistem i integruar për menaxhimin e mësimdhënies dhe shërbimeve drejtuar studentëve, nga aplikimi në Universitet, jetës universitare deri në mbrojtjen e diplomës.</p>			
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Në bazë të të gjitha formave dhe metodave të mësimdhënies qëndron sensi i autonomisë së studentit, duke u përpjekur për ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë student-mësimdhënës. Ka një komunikim mjaft të mirë mes studentëve dhe pedagogëve si në auditor ashtu dhe në zyrat e pedagogëve gjatë orëve të pritjes.</p> <p>Duke shqyrtuar formën e kontrollit të dijeve, por dhe nga intervistat me studentët rezulton se detyrat e kursit që përgatisin në mënyrë të pavarur studentët janë një formë e vazhduar e kontrollit të dijeve, proces në të cilin udhëzohen në mënyrë periodike nga pedagogët përkatës. Rezulton se pikët e fituara nga studenti nga vlerësimi i këtyre punëve të pavarura i shtohen vlerësimit final.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.3</p> <p>Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Duke shqyrtuar dokumentacionin mbi kapacitetet e UBT (<i>dok. nr. 42</i>), por dhe nga vizitat në institucion, rezulton se DMB ka hapësirë të konsiderueshme për realizimin e procesit mësimor dhe të kërkimit shkencor. Brenda kampusit të UBT ekzistojnë 7 laboratore didaktikë-shkencorë për studentët bachelor në varësi të DMB; po në varësi të DMB edhe qendra Mbrojtjes së Bimëve, me shumë mjedise laboratorike dhe didaktike në Shkozet dhe Rrushbull, Durrës. Kjo qëndër është referencë kombëtare për çertifikimin e materialit bimor apo analiza të tjera të kontrollit fitosanitar.</p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Një pjesë e mjediseve paraqitet në gjendje mjaft të mirë, <i>por përsëri, si thuhet edhe në raportin e analizës mësimore vjetore 2018 – 2019 (Dok. nr. 38: Raporti mësimor 2016-2017) edhe pse gjendja e mjediseve është përmirësuar ndjeshëm, sërish ka nevojë për zgjerim dhe plotësim në drejtim të mjediseve për stafin, sallave të leksioneve, të cilat janë të vogla për kurset me rreth 40-50 studentë. Diçka e tillë është vërejtur edhe konkretisht gjatë vizitave.</i></p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Rezulton se kjo pikë është plotësisht e realizuar, pasi të gjitha sallat vërehet prania e video-projektorëve dhe e mjeteve të tjera ndihmëse në dobi të procesit të mësimdhënies.</p> <p>Realizimi i procesit mësimor mbështetet përmes infrastrukturës informatike dhe teknologjisë në Fakultet dhe në DMB në dy aspekte:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Së pari</i>, në aspektin organizativ dhe strukturor, përmes sistemit dhe faqes së internetit, ku realizohet mbështetja e të gjithë procesit nga hyrja e studentit deri në dalje. • <i>Së dyti</i>, infrastruktura ndikon drejtpërdrejt në procesin e mësimdhënies/mësimnxënies përmes laboratorëve kompjuterikë për të realizuar praktikat/seminaret në module të caktuara.
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve (<i>Dok nr _19_Syllabuset Bachelor -.pdf</i>), rezulton se thuajse të gjitha disiplinat dhe modulet në këtë program studimi janë të pajisura me tekste mësimore dhe/ose cikle leksionesh të shkruara nga pedagogët përkatës. Nga shqyrtimi i detajuar i syllabuseve rezulton se tekstet mësimore janë pas viteve 2010, dhe të paktën 50% të tyre rezultojnë të botuar pas vitit 2015.</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të</p>	<p>Nga vizita në institucion konstatohet se biblioteka e institucionit është në kushte mjaft të mira, me salla leximi,</p>

<p>mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>salla kompjuterash në dispozicion të studentëve dhe staf të përkushtuar. Vërehet një shpërfillje nga ana e vetë studentëve për shfrytëzimin në maksimum të këtyre mjediseve që institucioni i ka vënë në dispozicion.</p> <p><i>Grupi i ekspertëve konstaton se në bibliotekë mungon pjesa më e madhe e teksteve bazë të këtij program studimi sipas literaturës së paraqitur në syllabuse. Në lidhje me këtë, sugjerohet që institucioni duhet domosdoshmërisht të përforcojë politikën bindëse për personelin akademik që janë dhe autorë tekstesh mësimore, që ata të dhurojnë minimum 3 kopje të tekstit në bibliotekën e institucionit. Ky është element i domosdoshëm jo vetëm për pasurimin e fondit të bibliotekës, por edhe një mundësi më e madhe shfrytëzimi nga ata studentë që nuk mund ta blejnë apo ta sigurojnë këtë tekst në forma të tjera.</i></p> <p>Në laboratorin e Mbrojtjes së Bimëve në Shkozë, Durrës, DMB disponon dhe një bibliotekë (dok. nr. 66), e cila përmban tituj librash të lidhur ngushtësisht me këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Në kuadër të Projektit Erasmus+ “Library Network Support Services” (LNSS), është pjesë e platformës Springshare LNSS, një platformë <i>online</i>, me burime informacioni shumë të pasura gjendet në linkun: https://lnss-albania.libguides.com/.</p> <p>Ndërsa, për të përcjellë informacionin kudo dhe kurdo, është krijuar në masën më të madhe katalogu <i>online</i> i Bibliotekës përmes linkut: http://ëë.al.cobiss.net/scripts/cobiss.</p> <p>Nga intervistat me studentët rezulton se ata nuk i përdorin shpesh libraritë <i>on line</i>. Nga shqyrtimi i RVB dhe dokumentacionit në dispozicion, rezulton se lidhjet <i>on line</i> janë të mundshme, por nuk përmbajnë ndonjë informacion të thelluar që lidhet drejtpërdrejt me këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dosjes rezulton se studentët shfrytëzojnë maksimalisht të gjitha mjediset laboratorike të DMB, si dhe qendrën e didaktikës eksperimentale, pjesë e UBT (Valias, Fushë Krujë), jo vetëm për realizimin e praktikave mësimore dhe laboratorike, por dhe zhvillimin e temave të diplomës (në rastin kur ato zhvillohen). Ajo çfarë konstatohet është se në shumë raste institucioni nuk mbulon koston e transportit.</p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-</p>	<p>Gjatë intervistave me stafin akademik rezulton se platforma e-learning ka qenë aplikuar në të kaluarën dhe ka rezultuar mjaft efektive, por momentalisht nuk aplikohet për shkak se</p>

line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	duhet bërë një pagesë periodike mujore. <i>Grupi i vlerësimit sugjeron gjetjen e mekanizmave financiarë për ta rivënë në funksion këtë shërbim.</i>			
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	Vendosja në platformën <i>on-line</i> të të gjithë informacionit dhe mundësia e aksesimit të tyre nga studentët përbën një mundësi efikase të përdorimit të kohës nga studentët dhe rritje të efektivitetit të tyre. Çdo anëtar i stafit akademik ka profilin e vet në faqen e UBT, ku aty mund të vendosë informacionin që dëshiron, i cili është lehtësisht i mundshëm. Studentët mund të sigurojnë në këtë formë shumë lehtë leksione apo informacione të tjera për elementë të caktuar të mësimdhënies. DMB ka krijuar një profil të plotë të saj, të cilin e pasuron herë pas here me materiale të reja: https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/departamenti-i-mbrojtjes-se-bimeve/rreth-nesh-about-us/home ; https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/departamenti-i-mbrojtjes-se-bimeve/master-shkencor-scientific-master .			
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Nga intervistat me studentët rezulton se ata kanë të drejtë të zgjedhin lirisht temat e diplomës dhe pedagogun udhëheqës, dhe gjejnë mbështetjen dhe asistencën e personelit akademik në çdo fazë të procesit. Departamenti përcakton kriteret dhe standardet e përgatitjes së një punimi diplome. Udhëheqësi i punimit të diplomës përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur edhe afatet e përafërta të realizimit të tij.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në	Rezulton se në mënyrë periodike institucioni koordinohet me njësinë bazë, duke analizuar raportet mësimore dhe kërkimore në mënyrë që të dalin në pah shqetësimet, dhe të gjenden një zgjidhje e tyre (<i>dok. nr. 37 dhe 38</i>). Sipas nenit 26 të Statutit të UBT (<i>_2_Statuti UBT_Miratar_2018.pdf</i>), Njësitë Ndihmëse në funksion të procesit mësimor-kërkimor janë:

<p>kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>a. Sektori i Mësimimit, Kurrikulave & Vlerësimit Institucional; b. Sektori i Kërkimit, Kooperimit Shkencor & Projekteve; c. Sektori i Informacionit & Transferimit të Njohurive; d. Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë & Publikun i cili përbëhet nga: Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë; Zyra e Marrëdhënieve me Publikun</p> <p>Veprimtaria e këtyre sektorëve disiplinohet me rregullore që miratohet nga Senati i UBT.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Nga shqyrtimi i rregullores së brendshme të FBM dhe DMB (<i>dok. nr. 6 dhe 7</i>) rezultojnë se njësia kryesore dhe ajo bazë kanë të përcaktuar qartë objektivat në drejtim të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe koordinojnë në mënyrë të vazhdueshme punën për këtë proces.</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Gjatë intervistave me stafin akademik dhe me studentët rezultoi se në mënyrë të vazhdueshme mbështeten nga njësia kryesore dhe ajo bazë për aplikimin e metodave inovative të mësimdhënies dhe se sigurohet baza materiale e nevojshme për këtë proces.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Kualifikimi i stafit akademik është një nga prioritetet e departamentit. UBT nxit pjesëmarrjen e pedagogëve në trajnime me qëllim zhvillimin dhe integrimin e aftësive të tyre. Personeli akademik i përfshirë rezultojnë të jetë mjaft i kualifikuar (<i>dok. nr. 20: CV-të e personelit</i>).</p> <p><i>Konstatohet se publikimet shkencore ndërkombëtare mbulohen me shpenzime personale të secilit personel akademik, gjë që domosdoshmërisht kufizon numrin e tyre.</i></p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajtojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Rezultojnë se institucioni disponon “<i>Udhëzuesin për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies</i>” (<i>dok. nr. 39</i>), por ky udhëzues përmban një informacion shumë bazik mbi përdorimin dhe zbatimin e metodave inovative të mësimdhënies.</p> <p>Ajo çfarë konstatohet gjatë intervistave me stafin akademik të DMB, është se stafi akademik më i ri në moshë përfshihet në auditor gjatë orëve të leksionit të realizuara nga personel akademik më me përvojë, në mënyrë që të thellohet më tej dhe të kualifikohet edhe në mënyrën e transmetimit të dijeve tek studentët.</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të</p>	<p>Konstatohet qartë se personeli akademik dhe ai ndihmës janë plotësisht të përkushtuar në procesin e mësimdhënies. Kjo dëshmohet edhe gjatë intervistave me studentët dhe është një proces që monitorohet periodikisht dhe nga Njësia e</p>

studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel institucional, e cila bashkëvepron për këtë qëllim me zyrën e zv.dekanit mësimor të FBM.			
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Ky aspekt është plotësisht i realizuar dhe kjo vërtetohet dhe nga analiza mësimore e DMB (<i>dok. nr. 32</i>). Gjatë takimit me stafin akademik u konstatua se ka qenë dhe mbetet përgjegjësi e personelit akademik të trajnuar, që të transmetojë tek studentët metodat dhe praktikat e reja të përfutuara, si përgjegjës për realizimin e programit të studimit. Këto metoda dhe këto njohuri transmetohen vazhdimisht tek studentët si me vlerë dhe të suksesshme.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Nga intervistat me studentët rezultojnë se ata njoftohen që në momentin e parë që prezantohen me lëndën dhe pedagogët përgjegjës mbi ngarkesën javore dhe semestrale të saj, numrin e krediteve, shpërndarjen e të gjithë elementëve të programit të studimit dhe me mënyrën e vlerësimit të vazhduar (40%) dhe final (60%). Gjithashtu format e kontrollit të dijeve përcaktohen në mënyrë shumë të qartë edhe në nenin 57 të rregullores së studimeve të UBT (<i>dok. nr.5</i>).
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në rastet kur lënda është e ndarë me module, të cilat mbulohen nga disa anëtarë të personelit akademik, studentët konfirmojnë se njoftohen në mënyrë të detajuar mbi metodologjinë e testimit, mënyrën e grumbullimit të pikëve brenda modulit, dhe shumën e pikëve të të gjitha moduleve deri në marrjen e vlerësimit final.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore	Rezultoni e dokumentuar në rregulloren e DMB (<i>dok. nr. 6</i>) dhe e shprehur qartë nga studentët gjatë intervistave, se gjatë të gjithë vitit, studentët nëpërmjet detyrave të kursit

realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	apo punëve të tjera të pavarura, praktikave laboratorike dhe mësimore, në sajë të performancës vetijake vlerësohen me pikë, të cilat i bashkëngjiten pikëve të marra në provimin përfundimtar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	Nga shqyrtimi i syllabuseve (<i>dok. nr. 19; Dok nr _59_Guida Bachelor.pdf</i>), por dhe nga intervistat me stafin akademik dhe studentët rezulton se 40% e vlerësimit realizohet në mënyrë të vazhduar gjatë vitit (seminare, labore, detyra kursi, teste paraprake etj.) ndërsa 60% e pikëve i takojnë provimit final.
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Grupi i vlerësimit e cilëson mjaft efektiv aplikimin e platformës ESSE 3, e cila mundëson hedhjen elektronike të notave, njoftimin e studentëve nëpërmjet llogarisë personale elektronike të tyre, dhe gjithashtu shërben si një skedar elektronik mjaft efektiv dhe i sigurtë për vlerësimet e studentëve ndër vite.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Brenda departamentit ka një procedurë të instaluar, e cila në fakt përdoret për të gjitha programet dhe është standarde. Komisioni përcaktohet nga përgjegjësi i departamentit në bashkëpunim me Zv. Dekanin për mësim dhe miratohet nga Dekani i Fakultetit. Komisioni përbëhet nga 2 anëtarë. Gjatë zhvillimit të provimeve 2 anëtarët e komisionit janë detyrimisht të pranishëm, proces ky që monitorohet me shumë seriozitet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel institucional (<i>Dok nr 8_X_Manualit i Cilesise Final.pdf</i>), e cila bashkëvepron për këtë qëllim me zyrën e zv.dekanit mësimor të FBM.
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime	Nga intervistat me studentët rezulton se provimi final shlyhet me shkrim dhe me gojë, dhe si rrjedhim në këtë rast sekretimi nuk funksionon.

<p>me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Studentët pohojnë se gjatë vlerësimit të vazhduar (40%), por dhe gjatë vlerësimit përfundimtar (me shkrim dhe me gojë) personeli akademik në mënyrë të vazhdueshme bën sqarime të qarta në mënyrë që edhe vetë studenti të ndërgjegjësohet mbi arritjet momentale dhe të mund të përmirësohet në të ardhmen.</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Procesi i provimit përfundimtar është i monitoruar në mënyrë mjaft korrekte në mënyrë që të mund të shmanget kopjimi dhe kësisoj, marrja e një rezultati të pamerituar.</p> <p>Në nenin 68 të rregullores së Fak (<i>dok. nr. 6</i>) paraqitet zhvillimi i provimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ndalohet hyrja në provim e personave të jashtëm, qofshin dhe anëtarë të personelit të universitetit, me përjashtim të drejtuesit të departamentit, dhe personave të tjerë të autorizuar me shkrim nga Dekani/Rektori/Rektorati për të kryer monitorim/kontroll; - Studenti nuk lejohet të futet në provim nëse nuk disponon një nga mjetet e mëposhtme të identifikimit: librezën e studentit/kartën e studentit/kartën e identitetit; - Gjatë provimit mund të lejohet përdorimi i mjeteve ndihmëse, por në asnjë rast i celularëve. Studenti që në provim përdor forma e mjete të palejueshme përjashtohet nga provimi; - Provimet me shkrim zgjasin jo më pak se 2, por jo shumë se 3 orë. Pas dhënies së tezës në provimin me shkrim nuk lejohet futja në provim e studentëve të tjerë të grupit, apo kursit përkatës.
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret</p>	<p>Studentët konfirmojnë se para hyrjes në provim atyre u bëhet i ditur vlerësimi i vazhduar, dhe gjatë provimit përfundimtar me shkrim dhe me gojë ata menjëherë mësojnë vlerësimin final nga shuma totale e pikëve të grumbulluara.</p>

përkatëse.				
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Rezulton se aplikohet me mjaft efektivitet sistemi elektronik i hedhjes së vlerësimeve finale dhe studenti informohet menjëherë nëpërmjet e-mailit personal mbi rezultatin. Studentët pohojnë se para hyrjes në provim atyre u bëhet i ditur vlerësimi i vazhduar, dhe gjatë provimit përfundimtar me shkrim dhe me gojë ata menjëherë mësojnë vlerësimin final nga shuma totale e pikëve të grumbulluara.			
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Nga intervistat me studentët dhe përfaqësues të ZSS dhe sekretarisë mësimore rezulton se brenda një periudhe prej 72 orësh nga momenti i hedhjes së notës (ku edhe studenti informohet menjëherë me e-mail) studenti mund të ankimohet tek komisioni i provimit mbi rezultatin (<i>Dok nr _9_Rregullore e ZSS.pdf</i>). Në rast se ankimimi rezulton i drejtë, nota mund të ndryshohet brenda këtij afati kohor. Pas këtij afati kohor, proces-verbali i provimit gjenerohet në mënyrë të pandryshueshme nga sekretaria mësimore. Gjithashtu edhe sipas nenit 71 të rregullores së fakultetit është e përcaktuar qartë procedura e ankimimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7	
Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese të studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Mbështetur në kurrikulat egzistuese në 3 vitet e fundit (<i>Dok nr _19_Kurrikula _2018-2019.pdf; Dok nr _19_Kurrikula 17-18.pdf; Dok nr 19_Kurrikulat _2016-2017.pdf; Dok nr _59_Guida Bachelor.pdf</i>), GVJ konstaton se ky program studimi, garanton formimin e specialistëve me aftësi të theksuara profesionale, kjo edhe për shkak të traditës shumëvjeçare dhe qëndrueshmërisë unike në nivel kombëtar. Rezulton se ky program studimi garanton përgatitjen e studentëve me informacionin themelor dhe specifik, teorik dhe praktik, të domosdoshëm në fushën e mbrojtjes së bimëve, si një nga emergjencat themelore të

	kohës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Mbështetur në kurrikulat egzistuese në 3 vitet e fundit (<i>Dok nr _19_Kurrikula _2018-2019.pdf; Dok nr _19_Kurrikula 17-18.pdf; Dok nr 19_Kurrikulat _2016-2017.pdf</i>), grupi i vlerësimit konstaton se ky program studimi zhvillon edhe lëndë të tilla si: Informatikë e aplikuar, Bazat e ekonomisë, Sociologji, Gjuhë të huaj etj.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Konstatohet gjatë intervistave me stafin akademik dhe studentët se, në përfundim të lëndës apo modulit, personeli akademik aplikon forma të ndryshme të informimit nëse janë realizuar dhe janë fituar kompetencat dhe aftësitë që duhet të marrë studenti në përputhje me objektivat e lëndës. Kjo realizohet nëpërmjet pyetësorëve me shkrim apo me gojë, rezultatet e detyrave të kursit etj. <i>Grupi i vlerësimit konstaton se regjistrimi i studentëve me mesatare relativisht të ulët është një faktor që vështirëson këtë proces, dhe kufizon deri diku arritjen e kompetencave dhe aftësive të larta në fund të çdo lënde.</i>
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	Studentët dhe stafi akademik pohojnë se midis tyre zhvillohen biseda të hapura mbi pritshmëritë dhe realizimin e objektivave të lëndës, çështje që diskutohen dhe në raportin e analizës mësimore në departament (<i>dokumentat nr. 37 & 38</i>).
Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Stafi akademik dhe studentët pohojnë realizimin dhe informimin e vazhdueshëm mbi përparimet e shkencës në këtë drejtim studimi nëpërmjet seminareve apo leksioneve të hapura.
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit (<i>dok. nr. 20: CV-të e stafit akademik</i>) rezulton se personeli akademik i përfshirë në këtë program studimi është mjaft i kualifikuar, gjë që rrit mundësinë e transmetimit të dijeve dhe përgatitjen e specialistëve me kompetenca të kënaqshme në këtë drejtim.
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e	Intervistat me studentët dëshmojnë se personeli akademik ndihmon dhe mbështet punën në grup, duke nxitur jo vetëm debatin, por dhe diskutimin e gjerë të inforcione të marra. Kjo vërtetohet nga fakti se një pjesë e mirë e detyrave të

problematikave/çështjeve të caktuara.	kursit, nuk janë punë individuale e studentit, por janë të realizuar në grupe me disa studentë, ku secili mundohet të japë kontributin e tij.			
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	Studentët konfirmojnë se personeli akademik mbështet çdo ide personale apo në grup mbi realizimin e një detyrë kursi, praktike profesionale apo teme diplome të sugjeruar nga vetë studentët.			
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	Nga bisedat me stafin dhe studentët <i>rezulton se mbështetja financiare për transport gjatë praktikave mësimore dhe profesionale nuk është gjithmonë e mundur. Diçka e tillë kufizon numrin e lëvizjeve në kuadër të praktikave mësimore dhe profesionale.</i> Por për këtë program studimi (si program i ciklit të parë të studimeve) një pjesë e praktikave në terren mund të realizohen dhe në mjediset e Kopshtit Botanik të UBT që gjendet brenda kampusit apo në parcela të tjera aty pranë.			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Grupi i vlerësimit konstaton se numri i mobiliteteve të studentëve në kuadër të programit ERASMUS, CEEPUS, DAAD, etj. (<i>dok. nr. 32 dhe 69</i>) është i lartë, gjë që dëshmon dhe për një përputhje të kurrikulës me universitete ndërkombëtare.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Nga intervista me ZSS rezulton se datat dhe procedurat e provimit final apo mbrojtjes së diplomës bëhen publike dhe studentët mund ta marrin lehtësisht këtë informacion (<i>Dok nr 9_Rregullore e ZSS.pdf</i>). Këto procedura janë të shprehura mjaft qartë dhe në rregulloret përkatëse të UBT, FBM dhe DMB.
Kriteri 2. Strukturat	Studentët pohojnë se janë të informuar që në fillim të

<p>përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>studimeve se arritja e një note mesatare mbi 8 u jep mundësinë atyre të realizojnë një temë diplome në fund të studimeve. Në të kundërt, ata i nënshtrohen provimit final të mbrojtjes së diplomës, për të cilin ata pajisen me materialet e nevojshme dhe me tematikat e çdo lënde që do të përfshihet në këtë provim.</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Konstatohet se miratohet paraprakisht një komision i posaçëm (<i>dok. nr. 70</i>) që administron dhe është përgjegjës për provimin final. Ky komision shqyrton tezat e provimit që kompozohen nga çdo anëtar i komisionit.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p>	<p>Studentët pohojnë se atyre i vihet paraprakisht në dispozicion materiali me elementët që do të përfshihen në pyetjet e provimit final; ata në çdo kohë mund t'i drejtohen pedagogëve përkatës të lëndës/modulit për paqartësitë që kanë.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Institucioni por edhe i gjithë departamenti organizohet në mbështetje të studentit duke konsultuar dhe orientuar jo vetëm me literaturë më të mirë dhe të përshtatshme për studentët por edhe orientuar për të shfrytëzuar burime individuale. Studentët që plotësojnë kriteret për përgatitjen e një teze diplome pohojnë se atyre u krijohen lehtësira për bazën materiale dhe infrastrukturën laboratorike për përgatitjen e temës së diplomës.</p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Studentët që plotësojnë kriteret për përgatitjen e një teze diplome, pohojnë se ata janë në kontakt të vazhdueshëm, asistohen dhe mbështeten vazhdimisht nga udhëheqësi i temës, jo vetëm për realizimin praktik të temës, por edhe për sjelljen përfundimtare të saj për mbrojtje para komisionit.</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së</p>	<p>Gjatë intervistave nga GVJ, studentët pohojnë se ato vlerësohen me notë në përfundim të provimit final ose</p>

diplomës, studenti vlerësohet me notë.	mbrojtjes së diplomës, vlerësim i cili i bëhet i ditur menjëherë nga komisioni (<i>dok. nr. 71</i>).			
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe intervistave me stafin akademik dhe ZSS, rezulton se studentët pajisen me diplomën përkatëse, e cila është dokument zyrtar. Bazuar në nenin 17 të rregullores së programit të studimit (<i>dok nr. 7</i>) ky model diplome "Bachelor" në programet e studimit hartohet nga FBM dhe miratohet nga Senati Akademik. Diploma shoqërohet me listën e notave dhe suplementin/shtojcën e diplomës (<i>dok. nr. 15</i>), sipas modelit të miratuar në rregulloren e UBT.			
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Gjatë takimit në Zyrën e Studimit dhe Studentëve (ZSS) u konstatua se studentëve u vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar, vetëm në rastet kur ai e kërkon këtë gjë. Studentët depozitojnë pranë kësaj zyre një kërkesë dhe brenda një afati të caktuar u jepet një kopje e firmosur dhe e vulosur e programit të studimit. Ky element përmbushet me efikasitet nga ZSS dhe është në përputhje të plotë me rregulloret e UBT, FBM dhe sekretarisë mësimore (<i>dok. 5, 6, 7 dhe 9</i>).			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Rezulton se i gjithë informacioni i domosdoshëm ruhet në sekretaritë mësimore sipas rregulloreve dhe udhëzimeve ligjore në fuqi. Ky informacion ruhet në hard copy (regjistrat themeltar), si dhe databazën digjitale sistemi ESSE3.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit,

Vlerësimi dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit (<i>dok. nr. 11: Rregullore e zyrës së Burimeve njerëzore; dhe dok. nr. 44: Formati i Dosjes personale të stafit</i>), por dhe nga intervistat në Zyrën e Burimeve Njerëzore, konstatohet se dosjet e personelit akademik për këtë program studimi janë të plotësuara dhe të përditësuara me të dhënat përkatëse.</p> <p>Gjithashtu, të dhënat e reja ju dërgohen instancave dhe paralel përditësohen në faqen e UBT, por edhe në faqen e çdo pedagogu të DMB. Në këto të dhëna përfshihet angazhimi i personelit akademik në program dhe angazhimi i çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik (<i>dok. nr. 25</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Konstatohet se e gjithë procedura e rekrutimit realizohet jo vetëm në përputhje me bazën ligjore në fuqi (<i>dok. nr. 11: Rregullore e rekrutimit UBT të Stafit Akademik, Ndihmës dhe Administrativ në UBT</i>), por edhe me aktet e brendshme rregullatore të vetë institucionit (<i>dok. nr. 2: Statuti i UBT</i>), i cili ka ndërmarrë një nismë rekrutimi të personelit të ri në moshë.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit janë pjesë e rregullores së Drejtorisë së Burimeve Njerëzore. E gjithë procedura për rekrutimin e personelit, dhe kriteret bëhen publike, dhe procesi realizohet nëpërmjet një konkurimi të hapur (<i>dok. nr. 11: Rregullore e zyrës së Burimeve njerëzore</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të</p>	<p>Nga verifikimi i procedurës së rekrutimit në Zyrën e Burimeve Njerëzore (<i>dok. nr. 11: Rregullore e zyrës së Burimeve njerëzore</i>), konstatohet se paraprakisht vendosen nga institucioni kriteret e përgjithshme dhe specifike për rekrutimin e personelit, në mënyrë që në pozicionin e shpalluar të lirë të punësohet individi që plotëson më së miri kriteret e përcaktuara.</p>

studimit.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Nga vlerësimi rezulton se jo në të gjitha rastet vërehet prania e hapësirave të mjaftueshme për stafin akademik në dobi të procesit të mësimdhënies, por edhe punës së tyre në drejtim të kualifikimeve të mëtejshme. Në disa raste vërehet se zyrat e personelit akademik janë brenda laboratorëve mësimorë. <i>Sugjerohet shqyrtimi i mundësive nga institucioni për zgjerim të mëtejshëm.</i>
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Stafi akademik rezulton të jetë mjaft i kualifikuar, <i>por në tërësi konstatohet se institucioni nuk mbështet financiarisht ndonjë publikim shkencor ndërkombëtar.</i> Gjithsesi, vlen për t'u theksuar numri i mobiliteteve dhe trainimeve të personelit akademik jashtë vendit, realizuar kjo falë projekteve të fituara nga institucioni (<i>dok. nr. 32</i>).
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Rezulton se platforma <i>e-learning</i> apo të tjera të ngjashme janë aplikuar me efektivitet, <i>por konstatohet se ato momentalisht nuk aplikohen për shkak të mungesës së mbështetjes financiare.</i> Rezulton se institucioni disponon “Udhëzuesin për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies” (<i>dok. nr. 39</i>), <i>por konstatohet se ky udhëzues përmban një informacion shumë bazik mbi përdorimin dhe zbatimin e metodave inovative të mësimdhënies.</i>
Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të	Nga analiza, vizita dhe shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se institucioni anagazhon maksimalisht stafin në dobi të procesit të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, <i>por GJVJ sugjeron se duhet të vlerësohet sërish ngarkesa mësimore e stafit akademik (dok. nr. 25), pasi në disa raste rezulton të jetë mjaft e lartë, gjë që ndoshta çënon cilësinë e mësimdhënies.</i>

parë.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Konstatohet se vetë institucioni bën përpjekjet e veta për të siguruar auditorët për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, por këto mjedise janë të përbashkëta për një numër të madh programesh studimi. Në disa raste, si konstatohet edhe nga raporti i analizës mësimore të vetë departamentit, rezulton se këto mjedise janë të vogla dhe, rrjedhimisht nuk përballojnë një numër të madh studentësh.
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Nga vizita në institucion dhe nga intervistat me stafin dhe studentët u vu re dhe pohohet se të gjithë auditorët janë të mirëpajisur me pajisje të teknologjisë së informacionit. Ky është element i rëndësishëm për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Cdo sallë është e pajisur me videoprojektor, gjithashtu laboratorët janë të pajisur me një numër të konsiderueshëm kompjuterash.
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë	Nga shqyrtimi i dokumentacionit në dispozicion (<i>dok. nr. 38: Raporti i analizës mësimore dhe kërkimore të DMB</i>), por edhe nga vizitat në institucion, vihet re se në disa raste nevojitet përmirësim i infrastrukturës dhe bazës materiale për plotësimin e aftësisë praktik të studentëve. Këto mangësi

aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	<i>lidhen me vlerat e ulëta të buxhetit që siguron institucioni.</i> GVJ konstaton se vetë DMB bën përpjekje të mëdha nëpërmjet projekteve bazë, duke siguruar materiale të domosdoshme për procesin e mësimdhënies.			
Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.	Si nga shqyrtimi i dokumentacionit, ashtu dhe nga intervistat e drejtpërdrejta, konstatohet se laboratore apo mjedise të tilla janë në dispozicion të të gjitha fakulteteve të UBT, dhe jo të DMB në veçanti (<i>dok. nr. 42</i>). <i>Kësisoj, nuk dokumentohet qartë shkalla e përdorimit nga studentët e këtij programi studimi.</i>			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe nga intervistat me stafin pohohet fuqishëm se institucioni zotëron marrëveshje (<i>dok. nr. 35</i>) me institucione shtetërore si: ISUV, MBZHR, AKU, etj., apo me sipërmarrës të kompanive të ndryshme specifike të sektorit privat, në sajë të të cilave studentëve u krijohen mundësi të mira për realizimin e praktikave profesionale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e	Konstatohet se biblioteka shkencore e vetë institucionit është në dispozicion të studentëve, jo vetëm përsa i përket titujve të librave apo sallave të leximit që ajo disponon. Rezulton se në mjediset e bibliotekës ka <i>WiFi</i> , mjediset janë komode dhe në

shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	kushte higjeno-sanitare dhe estetike të një niveli mjaft të lartë. <i>Por nga ana tjetër, ajo që vihet re është numri relativisht i vogël i studentëve që frekuentojnë këto mjedise dhe/ose shfrytëzojnë këto mundësi që institucioni vë në dispozicion. Kjo lidhet dhe me cilësinë e ulët të studentëve që ndjekin këtë program studimi.</i>
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Konstatohet se fondi i bibliotekës pasurohet nga buxheti i shpenzuar për tituj librash apo revista prestigjioze (<i>dok. nr. 68</i>), por u përmend gjatë intervistave që ky fond është relativisht i ulët. Një formë tjetër e pasurimit të bibliotekës është dhe me anë të dhurimit të titujve të librave. Gjatë intervistave u pohua <i>se çdo autor, libri i të cilit përdoret si tekst bazë apo alternativ në këtë program studimi duhet domosdoshmërisht të dorëzojë të paktën 3 kopje në bibliotekë. Por, nga shqyrtimi i literaturës në bibliotekë, u konstatua se këto tekste, në shumicën e rasteve, aty mungojnë.</i> Një aset shtesë i bibliotekës dhe i faqes së UBT janë punimet e disertacioneve të DMB, të cilat ndodhen të arkivuara në bibliotekë dhe në vitet e fundit edhe <i>online</i> në faqe: https://drive.google.com/file/d/1FQq6t4TscgfhQBB9zUYb4sPdIYUTZyYU/edit
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Në kuadër të Projektit Erasmus+ “ <i>Library Network Support Services</i> ” (LNSS), janë pjesë e platformës Springshare LNSS, një platformë <i>online</i> , me burime informacioni shumë të pasura: https://lnss-albania.libguides.com/ . Gjithashtu, për të përcjellë informacionin kudo dhe kurdo, është krijuar në masën më të madhe katalogu <i>online</i> i Bibliotekës: http://www.al.cobiss.net/scripts/cobiss .
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Nga vizita rezulton se biblioteka e institucionit disponon një sallë me rreth 10 kompjutera (<i>dok. nr. 68</i>), të cilët janë në dispozicion të studentëve gjatë orarit zyrtar të punës (08.00 – 16.00). <i>Duke qenë se kjo sallë përdoret nga të gjithë studentët e UBT, ky është numër relativisht i ulët i kompjuteravë krahasuar me numrin e madh të studentëve. Por, edhe në këtë rast, konstatohet, se numri i studentëve që i shfrytëzojnë këto mjedise është relativisht i ulët.</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit	Gjatë intervistave u pohua <i>se çdo autor, libri i të cilit përdoret si tekst bazë apo alternativ në këtë program studimi duhet domosdoshmërisht të dorëzojë të paktën 3 kopje në bibliotekë, por konstatohet se deri më tani kjo politikë institucionale nuk ka funksionuar.</i>

ekzistues në mbështetje të programit.	<i>GVJ rekomandon ndjekjen e politikave institucionale bindëse, apo dhe nxitëse për personelin akademik që të realizohet ky qëllim. Në këtë mënyrë jo vetëm të pasurohet fondi i bibliotekës, por i jepet mundësia studentëve që nuk kanë mundësi tjetër se si të sigurojnë një libër, të mund ta përdorin atë pa pagesë, por kundrejt rregullores së bibliotekës.</i>			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	<i>Biblioteka e UBT (dok. nr. 68) ka 4 hapësira me rreth 260 vende për t'u ulur, të cilët janë jo shumë për UBT, me mbi 7900 studentë; edhe orari i Bibliotekës, e hënë deri të premte, 8.00 – 16.00, na duket i kufizuar, për misionin e saj ku studentët mund të qëndrojnë jo vetëm për t'u konsultuar me një libër të bibliotekës, ose burim on-line, por edhe të studiojnë, dhe të zhvillojnë detyrat e tyre të radhës.</i> <i>Mendimi ynë është se ndihma e Bibliotekës për këtë qëllim duhet të jetë disi modeste për Programin në shqyrtim.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Gjatë shqyrtimit të DVV dhe vizitave në institucion u konstatua qartë se ekziston sistemi i menaxhimit të të dhënave dhe të gjithë informacionit që lidhet me studentët (sistemi ESSE 3), si nga stafi akademik, ashtu dhe nga studentët u pohua se ky sistem funksionon me efikasitet dhe ka lehtësuar dukshëm informimin në kohë reale për çdo aspekt që lidhet me procesin mësimor. Ky sistem është në shërbim primar të studentëve me synimin kryesor rritjen e cilësisë së shërbimit në çdo aspekt të procesit, që kur regjistrohen e deri sa diplomohen. Përmes këtij sistemi mirëmenaxhohet gjithë procesi, duke ofruar gjithë informacionin e nevojshëm për Programin, kurrikulën, planin mësimor, syllabuset, sistemin e vlerësimit etj.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe nga vizita në Zyrën e Burimeve Njerëzore, rezulton se administrohet dhe përditësohet me përpikmëri i gjithë informacioni, dokumentacioni dhe aktiviteti i të gjithë personelit të angazhuar, klasifikuar sipas

aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	kategorive përkatëse.				
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Konstatohet se institucioni ka faqen e tij (www.ubt.edu.al), në të cilin shfaqet i gjithë informacioni mbi fakultetet, departamentet, grupet mësimore-kërkimore, programet e studimit etj. I gjithë ky informacion rezulton të gjendet lehtë për personelin akademik, studentët dhe për audiencën e gjerë. Gjithashtu akses i dedikuar në informacionin e ESSE3 është i garantuar përmes <i>username</i> dhe <i>password</i> për secilin pedagog dhe për secilin student.				
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, si dhe nga intervistat me stafin dhe studentët u pohua se sistemi i menaxhimit elektronik mundëson hedhjen e teksteve në word, krijimin e menuve sipas organizimit vetiak të çdo pedagogu etj. Këto informacione gjenden lehtë nga studentët nëpërmjet një lidhje për çdo pedagog. <i>Gjithsesi, nuk dokumentohet konkretisht masiviteti në përdorim i kësaj platforme nga studentët.</i>				
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Gjatë intervistave u pohua se i gjithë informacioni i depozituar si nga DMB, ashtu dhe nga pedagogët gjendet dhe është i dukshëm në kohë reale.				
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Konstatohet se për disa elementë të caktuar informativë përdoren 2 gjuhë komunikimi (shqip dhe anglisht), <i>por në përgjithësi pjesa më e madhe e informacionit si në nivel institucional, ashtu dhe në nivel individual jepet në gjuhën shqipe.</i>				
Shkalla e përmbushjes së	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		

standardit				X
------------	--	--	--	---

Standardi IV.6	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se Zyra e Financë – Kontabilitetit, Departamenti i Financës (<i>dok. nr. 49 dhe 50</i>), harton çdo vit një raport financiar të kostove të departamenteve, si dhe shpenzimet për një student. Në përputhje me numrin e studentëve të regjistruar llogariten kostot e tjera. E gjithë kjo rezulton e domosdoshme për të siguruar mbështetjen financiare të DMB, e lidhur drejtpërdrejtë me mbarëvajtjen e procesit mësimor.</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV rezulton se plani i financimit të DMB përmban informacionin e detajuar mbi shpenzimet dhe të ardhurat (<i>dok. nr. 49 dhe 50</i>). Një element i rëndësishëm që vlen të përmendet është se DMB i siguron të ardhura shtesë institucionit nga shërbimet për të tretë nëpërmjet analizave që kryejnë dy labororet e referencës kombëtare, përkatësisht në Rrushbull dhe në Shkozet.</p> <p>Gjatë intervistave me stafin pohohet se pavarësisht se këto të ardhura i shkojnë institucionit, ato ‘kthehen’ në departament në formën e investimeve vjetore që institucioni realizon për DMB, për nevoja të veçanta të procesit mësimor dhe të kërkimit shkencor që lidhen me këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban</p>	<p>Sipas nenit 116 të Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015, auditivi në IAL bëhet përmes njërive të auditit të brendshëm të institucionit. Konstatohet se të gjitha pasqyrat financiare që rrjedhin nga auditimi i përvitshëm i UBT bëhen transparente edhe në nivel departamenti (<i>dok. nr. 49 dhe 74</i>).</p>

një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.				
Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	Gjatë shqyrtimit të DVV konstatohet qartë sipas (<i>dok. nr. 50_raporti financiar</i>) se realizohet në mënyrë të detajuar analiza e kostove dhe të ardhurave në mbyllje të çdo cikli studimi, ky fakt u verifikua edhe gjatë takimit me stafin akademik ku u pohua se ato marrin pjesë në diskutimet e domosdoshme në këto analiza për shfrytëzimin me efikasitet të të ardhurave.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	Bazuar në raportin financiar (<i>dok. nr. 50</i>), rezulton se institucioni ka qëndrueshmëri financiare por sërish konstatohet se buxheti mbetet i ulët për të realizuar në nivelin maksimal të mundshëm çdo kërkesë për përmbushjen e këtij programi studimi, në përputhje me kërkesat e kohës, si dhe motivimin sa duhet të stafit dhe mbështetjen e studentëve. Nga të dhënat, kostua mesatare për student në UBT për vitin 2018 është llogaritur në vlerën 118,900 lekë (<i>dok. nr. 50</i>). Por për mendimin tonë kjo vlerë mbetet përsëri e ulët krahasuar me sistemin universitar privat në Shqipëri, pa folur për sistemin universitar në rajon dhe më gjerë (<i>Gjonçaj, 2015; f. 35; https://www.arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/08/Raport_Final_Ministria_Arsimit.pdf</i>).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Konstatohet nga shqyrtimi i dokumentacionit, por dhe nga intervistat me Zyrat e Karrierës së Studentëve (ZKS) se aplikohen politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik për këtë program studimi (<i>dok. nr. 6, 7 dhe 9: Rregulloret FBM, DMB dhe ZKS; dok. nr. 5: Rregullorja e studimeve UBT</i>). Gjithashtu, janë edhe dy zyra nën varësi të Rektoratit, përkatësisht Dega e Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional (DZHKKVI) dhe Dega e Informacionit dhe Transferimit të Njohurive (DITNJ), të cilat ndërtojnë procedurat për studentët nga momenti i hyrjes e deri në daljen e tyre në tregun e punës (<i>dok nr. 12_13 Rregullore DZHKKVI & DITNJ Final_V.2017</i>)</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Edhe nga shqyrtimi i dokumentacionit (<i>dok. nr. 6, 7 dhe 9: Rregulloret FBM, DMB dhe ZKS</i>), por edhe nga intervistat me ZSS dhe studentët, rezulton se të gjithë studentët trajtohen në mënyrë të barabartë dhe nuk vërehen raste të diskriminimit gjinor, racor, fetar etj. Strukturat e njësisë bazë japin shërbimet dhe mbështetjen e tyre pa asnjë dallim dhe diskriminim për të gjithë studentët duke i trajtuar të gjithë në kushte të barabarta. ESSE3 dhe transparenca e informacionit mbështet procesin për garantim të të drejtave të njëjta.</p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Nga shqyrtimi i kalendarit të QKA vihen re qartë një sërë aktivitete (<i>dok. nr. 17</i>) nëpër shkollat e mesme, që kanë për qëllim informimin dhe prezantimin e këtyre programeve të studimit. Kjo bëhet me qëllim thithjen e studentëve me mesatare më të lartë në krahasim me prurjet e deritanishme. Konstatohet qartë se kjo zyrë realizon në mënyrë periodike këshillim të studentëve në varësi të nevojave të tyre profesionale. <i>Megjithatë, mbështetur në cilësisnë e ulët të studentëve që pranohen në vitin e parë (p.sh. 6.74 në vitin 2018-2019; dok. nr. 27), njësia përgjegjëse dhe gjithë strukturat në shërbim të institucionit duhet të gjejnë mënyra më të përshtatshme për rritjen e cilësisë së të rinjve që kërkojnë të ndjekin këtë Program studimi.</i></p> <p>Informacioni mbi përparimin përgjatë kursit të studimit, transferimet dhe njohja e studimeve të mëparshme mund të njihet nga studentët e interesuar përmes sistemit të informacionit. Publikimi i informacionit në faqen e UBT është garanti themelor për njohjen nga publiku.</p>

<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Departamenti shqyrton dhe propozon cdo vit kuotat dhe kriteret e pranimet të aplikantëve.</p> <p>Konstatohet qartë se në rregulloren e brendshme e DMB (<i>dok. nr. 6</i>) janë të paraqitura në mënyrë të detajuar kriteret për përfshirjen në këtë program studimi.</p>			
<p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Sipas nenit 22 të Rregullores së FBM (Dok. nr. 6), citohet se pranimet në FBM bëhen duke ndjekur udhëzimet dhe kuotat e përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse nga Këshilli i Ministrave apo MASR për vitin akademik përkatës. Gjithashtu, kriteret e përzgjedhjes jepen po në këtë Rregullore, dhe janë në përputhje me aktet e ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe maturën shtetërore.</p>			
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Rezulton se QKA përgjegjëse për këtë program studimi disponon numra kontakti të personave në të gjitha rrethet e Shqipërisë, të cilët angazhohen dhe informojnë nxënësit e shkollave të mesme mbi këtë program studimi dhe çdo element tjetër të domosdoshëm (<i>dok. nr. 17 & 75</i>).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.2</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit</p>	<p>Kohëzgjatja e studimeve, kushtet e kalimit në vitin pasardhës dhe ecuria e studimeve janë të parashikuara në Rregulloret e FBM dhe DMB (<i>dok. nr. 6</i>), Rregulloren e programit të studimit (<i>dok. nr. 7</i>) dhe nëpërmjet dokumenteve të publikuara dhe të përditësuara (<i>dok. nr. 19 & 25</i>).</p>

<p>akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Njohja nga publiku garantohehet nga publikimi i rregulloreve në faqen e UBT (http://ubt.edu.al/). Gjatë takimit me studentët u konstatua se ishin kryer edhe takime informuese me studentët e kursit të parë nga përgjegjësi i departamentit dhe stafi akademik, duke i informuar studentët mbi modulet, procedurat dhe mënyrat e ecurisë së studentëve përgjatë gjithë periudhës së studimeve.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Konstatohet se Rregulloret e FBM dhe DMB (<i>dok. nr. 6</i>), si dhe rregullorja e studimeve të UBT (<i>dok. nr. 5</i>) përcaktojnë qartë kriteret dhe procedurat për transferimin në të njëjtin cikël studimi, ekuivalentimin e programeve që transferohen, regjistrimin pas pranimit të transferimit, transferimin e studentëve të UBT drejt institucioneve të tjera etj.</p> <p>ZSS shërben për informimin e studentëve dhe për përgatitjen e dokumentacionit lidhur me kërkesat për transferim. (<i>Dok nr 12_13_Rregullore DZHKKVI & DITNJ Final</i>)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Këto janë elementë që rezultojnë të paraqitura mjaft qartë në rregulloren e programit të studimit (<i>dok. nr. 7</i>).</p> <p>Gjithashtu ky informacion gjendet edhe në syllabuset e lëndëve (<i>Dok nr _19_Syllabuset Bachelor -.pdf</i>). Gjatë takimit me studentët dhe pedagogët u vu re se procesi është transparent dhe nuk shprehën probleme apo pakënaqësi lidhur me procesin.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Konstatohet se ky informacion është publik dhe paraqitet në Rregulloret e FBM dhe DMB (<i>dok. nr. 6</i>) si dhe rregullores së studimeve të UBT (<i>dok. nr. 5</i>). Diplomimi bëhet me provim formimi dhe në raste të caktuara me punim diplome. Për këto ka disa akte të miratuara (<i>_10_Diplomimi i studentëve në Programin e Studimit të Nivelit të Parë.pdf; _10_Rregullore e Diplomimit-converted.pdf; _7_Rregullore e PS_MB.pdf</i>), ku përcaktohen qartë gjithë kriteret si për mbrojtjen me provim dhe me punim diplome. Konkretisht, edhe për punimin e diplomës ka kritere të përcaktuara për t’u punuar, dorëzuar dhe mbrojtur para Komisionit, dhe të gjitha këto informacione i komunikohen studentëve nëpërmjet stafit administrativ dhe atij akademik (Udhëheqësi i Diplomës).</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe</p>	<p>Konstatohet se institucioni organizon një sërë aktivitete për këtë qëllim, si p.sh. takime në shkolla të mesme etj.; aplikon forma të ndryshme të informimit të nxënësve të shkollave të mesme (postera, fletpalosje etj.) me qëllim thithjen e nxënësve me mesatare më të lartë (<i>dok. nr. 16; 17; 77</i>). Këto aktivitete pohohen dhe nga intervista me stafin akademik të DMB. <i>Por mendojmë se më shumë duhet bërë në këtë aspekt jo vetëm nga njësia përgjegjëse, por dhe nga vetë institucioni, apo dhe</i></p>

studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	<i>ministra përgjegjëse, në mënyrë që shpërndarja e studentëve kandidatë cilësorë të bëhet edhe nëpër degë të tilla me interes për bujqësinë dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Nga intervistat me studentët dhe nga gjithë dokumentacioni (<i>dok. nr. 5-9; 25</i>) konstatohet se studentët informohen që në fillim të studimeve në lidhje me këto çështje apo të tjera që kanë lidhje me këtë program studimi.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Nga intervistat me studentët dhe nga syllabuset (<i>dok. nr. 19</i>) konstatohet se studentët janë mjaft të informuar mbi përmbajtjen e lëndës, ndarjen në module, shpërndarjen e krediteve, personelin akademik përgjegjës për secilin modul, mënyrën e shlyerjes së lëndës etj. <i>Por GVJ konstaton se një paraqitje e detajuar e elementëve të veprimtarisë mësimore (si përsa i përket tematikës, ashtu dhe për ngarkesën javore e semestrale të tyre) mungon në syllabus (Dok nr _59_Guida Bachelor.pdf). Kjo paraqitje konsiderohet e domosdoshme jo vetëm për studentët e regjistruar, por edhe për faktin se këto syllabuse gjenden lehtë për publikun e interesuar; por saktësimi i tyre do të ndihmonte të interesuarit për informim më të qartë të asaj se çfarë realisht ofron ky program studimi me karakter të theksuar aplikativ. Si theksuam edhe në Fushën II.3 në Planin mësimor duhet të saktësohet edhe varësia mes lëndëve të ngjashme që ka caktuar njësi përgjegjëse për Programin e studimit, si dhe sasia e krediteve që duhen përfutur për të kaluar në vitin pasardhës. Ky informacion duhet të jetë i dukshëm qartë edhe në faqen e DMB (Dok nr _59_Guida Bachelor.pdf).</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen	Rezulton se QKA jep informacione të vazhdueshme në lidhje me mundësitë për punësim dhe orientimin drejt tregut të punës nëpërmjet ftesës që i bëhet studentëve për pjesëmarrje në panairin e karrierës (<i>dok. nr. 7</i>). <i>Por, konstatohet dhe pohohet</i>

institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	<i>dhe nga punonjësit e QKA se pjesëmarrja e studentëve në këto aktivitete është e ulët.</i>			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Gjatë intervistave nga studentët u pohua se ato janë plotësisht të informuar nga institucioni në lidhje me këto çështje dhe asistohen për informim të vazhdueshëm. Informacioni mbi orarin dhe sallat është i afishuar në stenda; sallat janë të etiketuara me numra, të cilat përputhen me informacionin në orar; zyrat e pedagogëve, stafit administrativ, gjithashtu, kishin numrat dhe emrat përkatës.			
Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	Konstatohet se studentët disponojnë llogaritë e tyre elektronike, nëpërmjet të cilave mund të marrin të gjitha informacionet e duhura në portalin elektronik. Nga studentët u pohua se ata përdorin faqen dhe profilet vetijake të pedagogëve për të marrë informacionet e nevojshme (https://www.ubt.esse3.u-gov.rash.al/auth/studente/).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	Gjatë takimit me Zyrën e Studimeve dhe Studentëve në UBT u vu re se mbahen me korrektesë dhe përpikmëri të plotë të gjitha statistikat e nevojshme për këtë program studimi (<i>dok. nr. 27</i>).
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë,	Nga vizitat në ZSS dhe sekretarinë mësimore, u vu re se puna për të përmbushur të gjithë këto elementë ishte e realizuar në mënyrë mjaft korrekte dhe tepër të saktë.

<p>tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>				
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Konstatohet gjatë vizitave se edhe kjo çështje realizohej me korrektesë të lartë nga ZSS dhe sekretaria mësimore. Gjithashtu, nga shqyrtimi i DVV rezultojnë një sërë dokumentash që tregojnë për të dhënat që disponon institucioni që prej fillimit të regjistrimit të studentëve e deri në diplomim, konkretisht:</p> <p><i>Dok nr.27_Mesataret e studenteve ne perfundim te studimeve;</i> <i>Dok nr 27_Nota mesatare e pranimeve 2018-2019;</i> <i>Dok nr 46_Manual si rregjistrohen studentet ne vitin e pare;</i> <i>Dok nr 27_Evidenca e stud. regjistruar_Total_V.2014-2019-.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Nga vizitat dhe nga intervistat vihet re se edhe sekretaria mësimore përdor sistemin ESSE 3 për ruajtjen e të dhënave, një platformë që, si u pohua edhe nga intervistat, rezulton tepër efikase dhe e sigurtë në përdorim. Cdo student pasi pajiset me username dhe password hap llogarinë e tij në ESSE3. Ruajtja e të dhënave është përgjegjësi e ZSS, e cila i ruan ato ndër vite.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>I gjithë informacioni mbi regjistrimet/aplikimet, të dhënat lidhur me moshën, shpërndarjen e tyre gjeografike, trajtimin me bursa, numrin e të diplomuarve, notën mesatare në hyrje dhe në dalje gjendet dhe përpunohet nga ZSS. Konstatohet se Qendra e Karrierës dhe Alumni përgatit; “Raportin e performancës së QKA” (<i>dok. nr. 17</i>), raport që përgatitet në bashkëpunim me personelin akademik të DMB.</p> <p><i>GVJ konstaton se numri i përgjithshëm i personave të diplomuar që plotësojnë formularin e punësimit është më pak se 150 individë në nivel institucioni. Nga përfaqësues të QKA, u pohua se individët e diplomuar shfaqin indiferencë të plotësimin të këtij pyetësori.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të

studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit (<i>dok. nr. 2 dhe 5</i>) rezulton se ky institucion angazhon studentët në organet vendimmarrëse dhe këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të IAL-ve në fuqi. Studentët organizohen në këshilla studentore në nivel fakulteti. Këshillat e studentëve janë organizata të pavarura, të cilat nuk ushtrojnë veprimtari ekonomike apo politike, por sigurojnë pjesëmarrjen e studentëve në procesin zgjedhor dhe koordinojnë pjesëmarrjen me përfaqësim në organet drejtuese.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se në statutin e UBT (<i>dok. nr. 2</i>) garantohet pjesëmarrja e studentëve në Senat, konkretisht në masën 10% (të numrit të studenteve).</p> <p>Konstatohet se edhe në rregulloren e FBM (<i>dok. nr. 6</i>) parashikohet formimi, organizimi dhe funksionimi i këshillave të studentëve.</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Sipas Rregullores së FBM (<i>dok. nr. 6</i>), në Kreun XII, Vlerësimi i Cilësisë), në Nenin 91, vihet re rishikimi periodik i programit të studimit, dhe saktësohen plotësisht elementët e nevojshëm</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë</p>	<p>Nga shqyrtimi i procedurës së rishikimit të kurrikulës (<i>dok. nr. 52</i>) rezulton se në këtë proces angazhohen edhe përfaqësues të studentëve të këtij programi studimi.</p> <p>Gjatë takimit me studentët u vu re se mendimi i studentëve për rishikimin dhe përmirësimin e programeve merrej parasysh përmes plotësisht të pyetësorit të studentëve, ku përmes pyetjeve</p>

sugjerimet e kontributin e tyre në to.	që lidhen me procesin mësimor apo informacionin në lidhje me lëndën.			
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Gjatë intervistave, nga studentët u pohua se atyre u jepet mundësia e shprehjes mbi çështje që kanë të bëjnë jo vetëm me procesin mësimor, por edhe me atë të etikës në sjellje dhe komunikim, të ankimimit të rezultatit të provimit etj. Nga studentët u pohua se gjithmonë kanë pasur reagimin e duhur institucional në rast kur haseshin shqetësime të caktuara.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Rezultoni se në institucion funksionon me efektivitet të lartë ZSS dhe sekretaria mësimore (<i>_9_Rregullore e ZSS.pdf</i>). Konstatohet se këto struktura realizojnë me korrektesë dhe përkushtim të lart detyrat e tyre në drejtim të informimit të studentëve etj. Edhe nga studentët u pohua njëzëri që sekretaria mësimore është në shërbim të plotë e me përkushtim të lartë.
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Konstatohet se në institucion funksionon dhe QKA (<i>Dok nr 17_Raport Performanca e QKA_2018_Gjurmimi i studenteve.pdf</i>), e cila, si pohohet nga studentët, informon mbi mundësitë për punësim apo zhvillimin e praktikave profesionale në mënyrë të vazhdueshme.

<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>QKA si zyrë që mbështet zhvillimin e karrierës së studentëve, ofron informacion mbi punësimin e mundshëm, praktikat, intershipin bazë të programeve përkatëse.</p> <p>Konstatohet se kjo zyrë është funksionale dhe realizon mjaft aktivitete informuese. <i>Po, si pohohet dhe gjatë intervistave dhe si konstatohet edhe nga (dok. nr._17_Raport Performanca e QKA_2018_Gjurmimi i studenteve.pdf), në shumë raste numri i studentëve pjesëmarrës në aktivitete apo që drejtohen për këshillim është mjaft i ulët.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Rezulton se QKA aplikon një formular që plotësohet <i>on-line</i> për individët e diplomuar në programet e studimit që ofron institucioni, me qëllim gjurmimin e e tyre përsa i përket të dhënave mbi punësimin.</p> <p><i>Konstatohet se numri i personave që e plotësojnë këtë formular është shumë i ulët, pavarësisht se nga përfaqësues të QKA u deklarua se kjo qendër insiston në mënyrë të vazhduar duke bërë thirrje nëpërmjet postës elektronike.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Konstatohet se institucioni ka ngritur dhe ka plotësisht funksionale Njësinë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, që vepron në nivel institucional bazuar dhe në Manualin e cilësisë (<i>dok. nr. 8</i>), dhe bashkëvepron me zyrën e zv/dekanit mësimor për bashkërendimin e punës në nivel fakulteti.</p> <p>Sipas këtij manuali, misioni vizioni i UBT e mbështet punën e vet në ndershmërinë, krijimtarinë, lirinë akademike, bashkëpunimin dhe shkëmbimin për kërkimet shkencore. Nga vizita në institucion me përfaqësues të kësaj zyre rezultoi se UBT ka ngritur prej disa vitesh një sistem të brendshëm të testimit, kontrollit, dhe monitorimit të cilësisë (<i>dok. nr. 37 deri 40</i>). Gjithashtu, është ndërtuar një procedurë efikase e marrëdhënieve midis departamenteve, fakulteteve dhe rektoratit/senatit.</p> <p>Me qëllim që të përmissohet në mënyrë të vazhdueshme puna mësimore, departamenti në bashkëpunim me NJSBC organizon vlerësimin e brendshëm të procesit mësimor dhe të kontrollit të dijeve nga studentët nëpërmjet anketimit në fund të çdo semestri.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Planit Strategjik të Zhvillimit të UBT (<i>dok. nr. 4</i>) konstatohet se vetë institucioni i kushton shumë rëndësi sigurimit të cilësisë. Konstatohet se për këtë qëllim realizohen analiza periodike ku diskutohen rezultatet e vlerësimit të studentëve, performancës së pedagogëve etj.</p> <p>Rezulton se vetë studentët janë pjesë aktive e këtij procesi nëpërmjet plotësimit të formularëve të vlerësimit para çdo sezoni provimesh.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit,</p>	<p>Rezulton se UBT ka kryer akreditimin institucional sipas Vendimit të BA Nr.11, datë 07.04.2017 për: “Akreditimin e Parë të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Bujqësor i Tiranës”, me kohëzgjatje 4 vite akademike. Afati i vlefshmërisë së akreditimit është deri më 06.04.2021.</p> <p>Konstatohet se vlerësimi institucional i ka paraprirë vlerësimit të jashtëm të këtij program studimi.</p>

vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.									
Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.	<p>Përveç NJSBC që funksionon në nivel institucional, rezulton se FBM ka krijuar dhe Komisionin e Sigurisë së Cilësisë, Programeve të Studimit dhe të Kërkimit Shkencor (<i>dok. nr. 80</i>), i cili ka në përbërjen e tij 4 anëtarë personel akademik dhe një anëtar përfaqësues të studentëve.</p> <p>Nga intervistat me stafin akademik u pohua se ky komision ka për detyrë vlerësimin periodik të rezultateve dhe veprimtarive mësimore e kërkimore, analizën e rezultateve të vlerësimit të studentëve etj</p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ngrë njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	<p>Nga shqyrtimi i hollësishëm i dokumentacionit dhe nga intervistat me përfaqësues të njëjësive të ndryshme në nivel institucional, u konstatua se e gjithë hierarkia e monitorimit, rishikimit, shqyrtimit të programeve të ciklit të parë funksionon me efikasitet. Në mbështetje të këtij konstatimi janë edhe statuti i UBT, Rregullorja e FBM, Rregullorja e DMB etj. (<i>dok. nr. 5, 6 dhe 7</i>).</p> <p>Zyra mësimore dhe e kurrikulave, e ngritur prej vitit 2016, pas daljes së kurrikulave të reja kontrollon brendinë e tyre në formë, lidhur me sistemin e krediteve, shpërndarjen në semestra etj. Kjo zyrë merret me menaxhimin e procesit të rishikimit vjetor dhe periodik të kurrikulave.</p>

<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni disponon Manualin e cilësisë (<i>dok. nr. 8</i>), në të cilin paraqiten mjaft qartë detyrat për Komisionin e Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë, Programet e Studimit dhe Kërkimit Shkencor, ku ndër detyrat themelore rezulton të jetë mikëqyrja e programit të studimit.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të RVB dhe gjatë vizitave pohohet se njësi të tilla si: Dega e Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional, dhe Dega e Informacionit dhe Transferimit të Njohurive, funksionojnë pikërisht për të vlerësuar me parametra të matshëm ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit. Ky konstatim bëhet me thjesht me anë të intervistave, <i>por GVJ nuk disponon ndonjë dokument për të vlerësuar realisht efektivitetin e këtyre njësive.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Gjatë intervistave me përfaqësues të zyrave përkatëse dhe me personelin akademik pohohet dhe pretendohet se “Zyra e sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit institucional” merr në konsideratë raportimet e vazhdueshme nga Dega e Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional dhe Dega e Informacionit dhe Transferimit të Njohurive, <i>por GVJ nuk disponon dokumentacion për të vlerësuar realisht efektivitetin e këtyre njësive.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>Nga GVB pretendohet se këto raporte bëhen publike në analizat vjetore të UBT, FBM dhe DMB, Raportet vjetore të publikuara për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë janë pjesë e Raporteve Vjetore të analizës mësimore dhe kërkimore të UBT, FBM, DMB.</p> <p>Në këto Raporte janë përfshirë rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë (<i>dok. nr. 37 dhe 38</i>).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në

tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Pranë UBT funksionon Dega e Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional; pjesë e strukturës së kësaj dege është Zyra e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional (ZSCVI)</p> <p><i>(Dok nr _30_Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë Informacion.pdf)</i>. Nga intervistat dhe shqyrtimi i RVB (<i>dok. nr. 1</i>) pohohet se Zyra e sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit institucional realizon periodikisht vlerësimin e brendshëm të Programit, në bashkëpunim të ngushtë dhe me përgjegjësin e njësisë bazë.</p> <p>Sigurimi i brendshëm i cilësisë realizohet përmes tre mënyrave:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Përmes pyetësorit të studentëve, i cili plotësohet çdo semestër; 2. Përmes asistimeve të pedagogëve të rinj nga pedagogë me përvojë; 3. Përmes vlerësimit të performancës së çdo pedagogu për vit akademik; <p>Analiza e këtyre elementëve bëhet në rang departamenti dhe konkludohet në dy dokumenta, analiza e punës mësimore dhe analiza e punës shkencore (<i>dok. nr. 37, 38 dhe 40</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Konstatohet mjaft qartë si nga shqyrtimi i dokumentacionit, ashtu dhe gjatë zhvillimit të intervistave me përfaqësues të ZSCVI dhe me studentët, se para sezonit zhvillohen anketime me studentë në të cilat bëhen pyetje që kanë të bëjnë me shumë elementë të vlerësimit të mësimdhënies (<i>dok. nr. 8</i>).</p> <p><i>GVJ konstaton se numri i studentëve që i përgjigjen këtyre anketimeve është relativisht i ulët.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të</p>	<p>Nga intervistat me përfaqësues të zyrave përkatëse dhe stafit akademik, pohohet se institucioni përdor një sërë metodash të drejtpërdrejta për të vlerësuar mbarëvajtjen e cilësisë së programeve të studimit (<i>dok. nr. 37, 38 dhe 40</i>).</p> <p>Janë përdorur metoda dhe instrumente të ndryshme për vlerësimin e mbarëvajtjes së programit të studimit. Këto metoda përfshijnë sondazhet e studentëve, intervista në panairin e karrierës, anketime nga të diplomuarit në UBT.</p> <p>Në këtë mënyrë vlerësohet performanca e programit si gjatë zhvillimit të moduleve me anketimin në përfundim të çdo</p>

<p>provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>semestri për të gjitha modulet, ashtu edhe në dalje me anketimet e karrierës dhe të diplomuarve.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>GVJ konstaton se e vetmja metodë e tërthortë e matjes së cilësisë së programit të studimit janë vetëm rezultatet e vlerësimit nga studentët (<i>dok. nr. 40</i>).</p> <p>Ndërkohë konstatohet se, përsa i përket kualifikimit të stafit akademik, DMB dhe FBM pohojnë se organizojnë çdo vit vlerësimin e performancës së stafit akademik dhe e paraqesin atë me anën e raporteve analitike (<i>dok. nr. 37, 38</i>).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi VI.4</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se ZSCVI përbëhet nga staf i përkushtuar dhe korrekt, dhe koordinon aktivitetin e saj me përfaqësues të FBM dhe sekretariatit për të garantuar që procedurat e verifikimit të brendshëm të cilësisë të jenë efektive. GVJ nuk ka konstatuar mekanizma institucionale matës mjaft të qartë që të vlerësojnë (dok. nr. 37 & 38), por dhe të nxitin dhe motivojnë për praktikat më të mira, dhe performancën akademike dhe shkencore më të lartë, por edhe të masave ndaj performancës më të ulët të stafit.</p> <p><i>Këshillojmë për të gjetur mekanizma institucionalë të tillë që nxitin dhe motivojnë stafin mësimor dhe atë ndihmës lidhur me praktikat më të mira, dhe performancën akademike dhe shkencore më të lartë që ata ofrojnë.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>GVJ konstaton se stafi i ZSCVI, i përbërë prej 3 anëtarësh të personelit akademik, ka detyra konkrete e të ndara qartë brenda grupit, dhe delegon detyra konkrete në bashkëpunëtorët e vet brenda fakulteteve.</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga intervistat me përfaqësues të ZSCVI, pohohet se ato kanë një bashkëpunim të ngushtë me zyrën e zv/dekanit mësimor të FBM dhe përgjegjësin e departamentit të programit të studimit, të cilëve i delegohen detyra konkrete sipas hierarkisë së tyre.</p> <p>Përfshirja e të gjithë aktorëve, si njësi bazë, anëtarët e personelit akademik dhe studentët e programit është një element thelbësor i garantuar në vlerësimin e sigurimit të cilësisë së programit. Gjithashtu, edhe ngritja e GVB është një shembull tipik në këtë drejtim. Nga 5 anëtarë të GVB, 4 anëtarë janë pjesë e stafit akademik ku njëri është përgjegjësi i departamentit dhe 1 është përfaqësues i studentëve.</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton se me të drejtë ZSCVI verifikon çdo raportim mbi personelin akademik dhe ndihmës/akademik dhe tregohet tepër e kujdesshme jo vetëm në zgjidhjen e problematikave që rrjedhin nga studentët kur vërtetohet se ka të tilla, por edhe përkujdeset për të ruajtur dhe konsoliduar dhe integritetin akademik duke shmangur format e ndryshme të diskriminimit apo të trajtimit të pabarabartë.</p>

<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>DMB dhe FBM pretendojnë se palë të këtij procesi bëjnë dhe bashkëpunëtorët e jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi VI.5</p> <p>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Nga studentët dhe stafi akademik u pohua se organizimi dhe veprimtaria e ZSCVI bëhet publike në mënyrë të vazhdueshme.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Nga studentët dhe stafi akademik u pohua se ato njihen me rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit. Stafi akademik pohoi se këto rezultate diskutohen gjatë analizave vjetore mësimore në departament dhe diskutohet gjerësisht për zgjidhjen e shqetësimeve (nëse ka të tilla) (<i>dok. nr. 38</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të</p>	<p>Nga stafi akademik dhe përfaqësues të dekanatit pohohet se në rast të shfaqjes së shqetësimeve të ndryshme, përpilohet një plan</p>

shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	masash që synojnë zgjidhjen e tyre në mënyrë të menjëhershme (<i>dok. nr. 38</i>).			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	GVJ konstaton se institucioni në përgjithësi dhe anëtarët e ZSCVI-së në veçanti, punojnë me seriozitet me qëllim përmirësimin e cilësisë së programit të studimit. <i>GVJ sugjeron që në ndihmë të kësaj zyre në nivel institucional të përfshihet një punonjës i karakterit administrativ, në mënyrë që të lehtësohet sadopak puna e 3 anëtarëve të stafit akademik (anëtarë të kësaj zyre), të cilët krahas kësaj detyre kanë detyrim dhe ngarkesën mësimore vjetore në auditor.</i>			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Gjatë intervistave, nga studentët u pohua se atyre në mënyrë të vazhdueshme u bëhet thirrje për plotësimin e formularëve të vlerësimit, si dhe për evidentimin e problematikave të ndryshme që mund të hasin.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X